



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë  
Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar”  
“Universiteti Bujqësor i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof As. Arlinda Ymeraj

Dr. Valbona Kapllani

Gusht/2020

## **PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në "Ekonomiks i Aplikuar" ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe i Politikave të Zhvillimit Rural (DEPZHR), në "Universitetin Bujqësor të Tiranës".

Institucioni i Arsimit të Lartë, publik, " Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) u themelua në vitin 1951 si Instituti i Lartë Bujqësor në bazë të VKM Nr.548, date 28.07.1951, ndërsa në vitin 1991 iu ndryshua emërtimi në "Universiteti Bujqësor i Tiranës",

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 11, datë 07.04.2017 "Për akreditimin institucional të Universitetit Bujqësor të Tiranës", me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 06.04.2021.

Aktet rregullatore të IAL-së, Statuti e Rregulloret e Institucionit janë rishikuar në përputhje me ligjin për arsimin e Lartë dhe aktet normative në fuqi, siç janë konstatuar dhe nga GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave në IAL. Institucioni ka përgatitur një Plan Strategjik i cili është i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të programit të studimit si dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen.

Universiteti Bujqësor i Tiranës përbëhet nga **6 njësi kryesore/Fakultete**, dhe programi i studimit Bachelor në "Ekonomiks i Aplikuar " ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), që përbëhet nga **6 njësi bazë/Departamente**:

- Departamenti i Drejtimit Agrobiznesit
- **Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural (departamenti përgjegjës)**
- Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit
- Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural
- Departamenti i Matematikës dhe Informatikës
- Departamenti i Gjuhëve të huaja.

*Licencim:* Programi i studimit është hapur me UMASH nr. 208 datë 31.05.2013, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 460 datë 03.05.2013, me emërtimin Bachelor në "Ekonomi dhe Agrobiznes" me profile: *a. Ekonomiks i Aplikuar; b. Informatikë Biznesi*, si program studimi i ciklit të parë, dhe realizohet me 180 kredite me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Ky licencim u mbështet mbi vendimin e Rektoratit, Nr.43 datë 26.12.2012 dhe Senatit, Nr.39 datë 27.12.2012, të cilët konsideruan Vendimin e Këshillit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Nr. 13, date 23.11.2012, sipas propozimit të dekanatit të FEAs.

Me urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 586, datë 18.12.2019 ndryshon pika 1 e urdhërit nr. 208, datë 31.05.2013, dhe 2 profilet hapen si 2 programe të ndryshme Bachelor.

*Akreditimi:* Ky program akreditohet për herë të parë

Urdhëri për aprovimin e modelit të Diplomës Nr. 405, datë 08.09.2017, i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka akoma emërtimin e vjetër të programit: "Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në "Ekonomi dhe Agrobiznes", profili Ekonomiks i Aplikuar".

Programi i ciklit të parë ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe dhe kohëzgjatja e tij është 3 vite akademike, me 180 ECTS. Ky program studimi është hartuar në konsideratë të zhvillimeve social-ekonomike të vendit tonë si dhe një analize të tregut të punës. Siç paraqitet në dokumentat orientuese të IAL-së, programi synon t'u ofrojë studentëve njohuri të thelluara në ekonomi dhe politika të zhvillimit rural, me synim përgatitjen e vendimmarrësve, menaxherëve dhe studjuesve të ekonomisë me drejtim zhvillimin bujqësor.

Programi i ciklit të pare, Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh dhe specialitetesh si menaxher financiar, ekonomist dhe analist tregu, ekonometricien/staticien, analist biznesi, analist agrar, ekonomist mjedisi dhe burimesh natyrore, ekonomist në njësitë e qeverisjes vendore etj., duke plotësuar nevoja të konsiderueshme të tregut dhe institucioneve publike e jo publike, në vijim të realizimit të objektivave e prioriteteve strategjike të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Programi i studimit Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar” mbështet profilizimin dhe zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve. Kjo është një mundësi për lidhjen e studentëve me një sektor apo profesion që në ciklin e parë të studimit.

Përparësi e programit mësimor konsiderohet praktika mësimore me një kohëzgjatje 12 javore, e cila iu siguron studentëve mundësi njohje dhe kontaktimi me operatorët publikë dhe jo publikë, por gjithashtu edhe familiarizim e përvetësim të shprehive praktike, aq të nevojshme përgjatë tranzicionit nga shkolla në tregun e punës si edhe për ndërtimin e një kariere të qëndrueshme profesionale.

GVJ kërkoi dhe aksesoi gjatë vizitës të dhënat lidhur me përbërjen e stafit, titujt akademikë dhe ngarkesën e personelit akademik. GVJ vlerëson se personeli akademik, ndihmës mësimor–shkencor dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit dhe të zhvillimit të institucionit. Institucioni zotëron të dhëna të sakta për veprimtarinë e kualifikimit të vazhdueshëm profesional.

Institucioni realizon vlerësim të programit të studimit nëpërmjet pyetësorit të studentëve. Vlerësimi zhvillohet gjithashtu nga drejtuesi i njësisë bazë, por edhe në nivel Fakulteti nëpërmjet shkëmbimit interaktiv me stafin dhe vlerësimeve në fund të vitit bazuar në veprimtarinë shkencore të personelit akademik, të cilat rezultojnë të dokumentuara në departamentin e Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural si njësi përgjegjëse e programit.

Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional mat ecurinë e programit të studimit për qëllime përmirësimi duke përdorur një metodologji me instrumente matëse dhe vlerësuese si pyetësorët për studentët, raporte të njësisë kryesore e njësisë bazë, vlerësime për pedagogët nga Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural, por edhe Fakulteti.

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka trashëguar godinat e Institutit të lartë Bujqësor si edhe hapësirën e gjelbër rreth godinave, duke krijuar një infrastrukturë të qëndrueshme për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative, në funksion dhe të programit Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar”. GVJ tërheq vëmendjen për përmirësimin e kushteve fizike të institucionit dhe pajisjen e auditoreve me ngrohje, mensë për studentët si edhe lehtësimin e transportit publik.

Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, një bibliotekë e pasur dhe e përditësuarë me literaturë bashkëkohore, gjithashtu edhe pjesë e rrjeteve dixhitale duke lehtësuar aksesin e studentëve. Sidoqoftë, kufizimet në njohjen e thelluar të gjuhëve të huaja, vështirësojnë aksesin e studentëve dhe ulin efektivitetin e shërbimit.

Pranimi i studentëve në këtë program studimi është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe Statutit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, Rregullores së Fakultetit, Departamentit dhe të Programit.

Në regjistrin e administruar nga sekretaria mësimore e institucionit janë pasqyruar të dhënat e studentëve të regjistruar në këtë program studimi në përputhje me dokumentacionin që gjendet në dosjen e studentit, e cila u verifikua dhe me vizitën e GVJ bazuar në një përzgjedhje të rastësishme.

Institucioni mban të dhëna dhe kontakte me studentët e këtij programi përmes sistemit të komunikimit të brendshëm, ku çdo student ka hapësirë vetjake të dedikuar përmes të cilit informohet e ka akses në dokumentacionin elektronik. GVJ konstatoi se përmes sektorit të Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës

institucioni mban kontakte me studentët dhe pas përfundimit të studimeve. GVJ rekomandon një transparencë më të madhe të institucionit në lidhje me punësimet e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi si dhe krijimin e mundësive të punësimit për studentët që frekuentojnë programin aktualisht.

Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe vendase e të huaja me qëllim kualifikimin e mëtejshëm të stafit, tërheqjen e studentëve të huaj, ndërtimin e programeve të reja të studimit dhe ndërkombëtarizimin.

Krahas identifikimit të përparësive që burojnë nga diploma unike e këtij institucioni si edhe barasvlefshmëria e saj me diploma të ngjashme në Europë dhe botë, GVJ konstatoi se institucioni duhet të adoptojë proceset dixhitale veçanërisht gjatë testimeve ndërmjetëse dhe përfundimtare, me qëllim rritjen e transparencës dhe minimizimin e abuzimeve.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar” ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procesi nisi me kontaktin me ekspertët, të cilët u trainuan për standardet e cilësisë dhe kriteret, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë fazë të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe koordinatori Teknik i ASCAL.

Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion. Në fazën e dytë, ndonëse u shkaktuan disa vonesa për shkak të pandemisë COVID-19, u zbatua me rigorozitet axhenda e takimeve në 23.06.2020, gjatë vizitës në institucion.

GVJ mblodhi informacion të nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takime me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjësen e Departamentit të Ekonomisë dhe Politikave të zhvillimit Rural Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Zyrës e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit të informacionit, Zyrën e Mësimit dhe të Kurrikulave, Sekretarinë mësimore, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Studentët e programit të studimit. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga Prof. As. Arlinda Ymeraj dhe Dr. Valbona Kapllani për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Gjatë të gjithë procesit GVJ u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Znj. Renata Qatipi.

**Shënim:** Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL Universitetin “Bujqësor të Tiranës” është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 datë 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

Më datë 31.07.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. .. Prot., datë 30.07.2020 “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, Universiteti Bujqësor i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UBT përcjell përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë nga Përgjegjësi i Departamentit, datë 04.08.2020 “Komente mbi draft raportin e eksperteve të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit Ekonomiksi i Aplikuar”.

Në këtë dokument Departamenti ka disa komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm.

GVJ, pasi u njoh me komentet e UV sqaron si më poshtë:

### 1. Paragrafi në draft RVJ

**Standardi I.5 Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.**

*Megjithatë GVJ gjykon që decentralizimi i aktivitetit, të paktën i marrëdhënieve me të tretët, do të siguronte më shumë hapësirë bashkëpunimi dhe do të rriste efektivitetin e këtyre bashkëpunimeve.*

### Komenti i UBT:

Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të zhvillimit Rural, si të gjitha njësitë e Universitetit Bujqësor të Tiranës, në zbatim të Ligjit 80/2015, po ridimensionohet roli i departamenteve si njësi kryesore mbi të cilin mbështetet mësimi dhe kërkimi në IAL. Në këtë kuadër, është parashikuar edhe rritja e pavarësisë së departamenteve dhe krijimi i marrëdhënieve të drejtpërdrejta me të tretët.

**GVJ:** GVJ vlerëson angazhimin e strukturave përkatëse për ridimensionimin e rolit të departamentit dhe rritjen e pavarësisë së tij. Megjithatë vlerësimi i dhënë më sipër nga GVJ është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë kohës së vizitës në institucion. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

*Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.*

## **2. Paragrafi në draft RVJ**

**Standardi I.5 Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.**

*GVJ konstaton që departamenti nuk kryen trajnime të studentëve pas diplomimit.*

### **Komenti i UBT:**

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka në strukturën e tij një qendër trajnimesh e cila quhet Qendra e Trajnimeve Profesionale, e cila grumbullon dhe trajton nevojat që kanë studentët e diplomuar në UBT por jo vetëm, për trajnime gjatë jetës së tyre profesionale. Kjo qendër, paraqet pranë departamentit nevojat për trajnime të cilat plotësohen nga anëtarët e departamentit. Së fundi, pranë departamentit kanë ardhur kërkesa për të zhvilluar kurse trajnimi profesional për "Agjentë të Zhvillimit Rural" që i drejtohet specialistëve të zhvillimit, në nivel bashkish, në nivel qendror etj. DEPZHR, ka hartuar një marrëveshje bashkëpunimi me ISRE, Venecias, dhe VIS Albania, për të mundësuar bashkë hartimin e moduleve, si edhe financimin e grupit të parë të moduleve. Marrëveshja e cila ishte parashikuar për tu nënshkruar nga Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës në fillim të marsit të këtij viti, por që mbyllja e aktiviteteve si pasojë e situatës shëndetësore e shtynë për në shtator. Objektivi i pritshëm për fillimin e këtyre kurseve të trajnimit profesional, është semestri i dytë i vitit akademik 2021-2022. (Gjeni bashkëngjitur si aneks projekt kontratën midis UBT ISRE të Venecias si edhe VIS Albania).

**GVJ:** GVJ vlerëson angazhimin dhe përkushtimin e strukturave përkatëse për trajnimet që do të bëjnë në të ardhmen. Vlerësimi i dhënë më sipër nga GVJ është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë kohës së vizitës në institucion. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

*Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.*

## **3. Paragrafi në draft RVJ**

**Standardi II.1**

**Përbushet kryesisht**

### **Komenti i UBT:**

Ka një vlerësim të përgjithshëm përbushet kryesisht. Nga leximi i kujdesshëm i raportit të GVJ, nuk arrijmë të gjejmë pikat në të cilat duhet të përmirësohet puna jonë në të ardhmen. Ju lutem a mund të specifikoni se cilat janë komentet e GVJ-së që kanë prodhuar vlerësimin përfundimtar të këtij standardi.

**GVJ:** GVJ konstaton se sa më sipër është një lapsus që tashmë është sistemuar duke korigjuar vlerësimin e standardit II.1 në “përmbushet plotësisht”.

*Ndryshimi i këtij vlerësimi nuk influencon në vlerësimin e fushës 2.*

#### **4. Paragrafi në draft RVJ**

##### **Standardi II.2 .**

GVJ gjykon se Njësia Kryesore përgjegjëse për programin përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Sidoqoftë duhet të sqarohet se cili informacion është i saktë, përkatësisht 2018-2019 apo 2019-2020. Në rast se të dy informacionet janë të sakta, atëherë duhet të shpjegohen arsyet e ndryshimit.

##### **Komenti i UBT:**

Informacionet rreth stafit për vitet akademike 2018-2019, dhe 2019-2020, dëshmojnë ndryshimet në staf akademik të ndodhura në këtë periudhë.

Ndryshimi prej tetë pedagogësh të evidentuar edhe në komentin e GVJ-së, vjen si pasojë e:

- Ndryshimit të strukturës së organizimit të departamenteve brenda fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Në vitin akademik 2019-2020, Grupi Mësimor Kërkimor i Statistikës kaloi nga Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural në varësi të departamentit të Matematikës dhe Informatikës, për vetë afinitetin që kanë këto fusha. Ky ndryshim uli numrin e pedagogëve të DEPZHR me 6 pedagogë.
- Asistent lektorja O. S. e cila vazhdon studimet në doktoratë në universitetin e Hohenheim (Gjermani), shkëputi marrëdhëniet e punës me UBT në shtator 2019, dhe DEPZHR ka hapur procesin e rekrutimit të një asistent lektori të ri, proces i cili është nuk është realizuar akoma për vetë situatën aktuale.
- DEPZHR në kuadër të projekteve të bashkëpunimit me GIZ, ka në organikën e saj edhe punonjësen shkencore gjermane Dr. I. C. e cila mbulon projektet dhe thithjen e tyre në nivel departamenti por që nuk merr pjesë në mësimdhënie. Gabimisht në dokumentin e vitit 2019-2020, Dr. I.C. nuk është përfshirë.

**GVJ:** GVJ vlerëson sqarimet e dhëna lidhur me ndryshimet e ndodhura por gjykon se GVB duhet të ishte kujdesur më shumë për përditësimin e informacionit në dokumentacionin e paraqitur apo dhe gjatë takimit të organizuar në institucion. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

*Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.*

#### **5. Paragrafi në draft RVJ**

**Standardi III.6 Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.**

GVJ - Sidoqoftë, nevoja e digjitalizimit të vlerësimit mbetet një koment i vlefshëm.



### **Komenti i UBT:**

Digjitalizimi i procesit të vlerësimit është një objektiv konstant jo vetëm i këtij programi studimi. Të vetëdijshëm për këtë problematikë, institucioni kishte parashikuar kryerjen e kontrollit të provimeve duke përdorur Clean Score për pjesën përmbajtësore si edhe një program për sekretimin me kod shifror të provimeve. Clean Score është efektiv dhe do të përbëjë mënyrën kryesore të vlerësimit në sezonet në vijim. Po kështu edhe procesi i sekretimit duhet të jetë efektiv në sezonet në vijim të provimeve. Situata e re që po jetojmë, kërkon edhe ndryshime në procesin e mësimit dhe vlerësimit duke kaluar nëpër metoda të reja dhe të mbështetura në rritjen e nivelit të digjitalizimit.

**GVJ:** GVJ vlerëson angazhimin e strukturave përkatëse për digjitalizimin e procesit të vlerësimit. Megjithatë vlerësimi i dhënë mësipër nga GVJ është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë kohës së vizitës në institucion. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

*Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.*

### **6. Paragrafi në draft RVJ**

**Standardi IV.6 Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.**

*GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare në mbyllje të një cikli të plotë studimi tre vjeçar, por në raportet e analizës vjetore në nivel institucioni analizohen të ardhurat dhe shpenzimet mbi bazë viti buxhetor dhe bëhet edhe një analizë krahasuese e realizimit të tyre kundrejt shumave të buxhetuara më parë.*

### **Komenti i UBT:**

Procesi i decentralizimit financiar në UBT, është realizuar në nivel fakulteti dhe jo në nivel departamenti apo programi studimi. Ky proces i cili ka filluar tashmë, është një risi jo vetëm për UBT por IAL publike në përgjithësi. Një ndër objektivat e shprehur të institucionit është që të mbyllë sa më shpejt këtë proces, i cili do të bëjë të mundur që të llogariten edhe treguesit financiarë për student apo analizat financiare në nivel programi studimi.

**GVJ:** GVJ vlerëson angazhimin e UBT dhe të gjithë strukturave përkatëse në realizimin e procesit të decentralizimit financiar. Megjithatë vlerësimi i dhënë mësipër nga GVJ është bazuar në informacionin e marrë nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e organizuara gjatë kohës së vizitës në institucion. Konstatimet e GVJ qëndrojnë përpos sqarimeve dhe komenteve të reja të dhëna nga UV.

*Vlerësimi i këtij kriteri mbetet i pandryshuar.*



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Ekonomiks i Aplikuar"

### I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në "Ekonomiks i Aplikuar" i ofruar nga departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, është në përputhje me Misionin dhe Qëllimet e Institucionit të shprehura tek Plani Strategjik i UBT 2016-2025, miratuar në qershor 2016, Pika 1.1 dhe 1.2.</p> <p>Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimeve ekonomike e sociale të vendit. Ai i paraprin sfidave të politikave të zhvillimit rural në vendin tonë në mbështetje të interesave kombëtare si edhe të prioritetëve të zhvillimit, siç edhe përcaktohen tek Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020, objektivi 4, pika c.</p> <p>Gjithashtu zbatimi i politikave efektive të zhvillimit rural ka nevojë për specialistë të kualifikuar, të aftë që të plotësojnë kërkesat në rritje të ekonomisë dhe sipërmarrjes në vend. Kësaj prirje i përgjigjet UBT me programin e studimit Bsc në "Ekonomiks i Aplikuar" i cili mbështet profilizimin dhe zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve që në ciklin e parë të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të UBT-së u konstatua se programi Bsc në "Ekonomiks i Aplikuar" përbën risi në ofertën akademike të fakultetit, të transformuar për t'ju përgjigjur nevojave të zhvillimit të vendit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programet e studimit të ciklit të parë Bachelor ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e UBT, të përcaktuara tek strategjia për zhvillimin e UBT, tek e cila nënvizohet:</p> <p>"UBT kërkon të përgatisë jo vetëm specialistë të kualifikuar të fushës së bujqësisë, të ushqimit dhe mjedisit, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë, veçanërisht për prodhimin bimor, prodhimin shtazor; hortikulturë; mbrojtjen bimësh; akuakulturën dhe peshkimin; agromjedisin &amp; mbrojtjen e tij; ekonominë agrare; politikat bujqësore; zhvillimi i integruar rural; menaxhimin e ndërmarrjeve; marketingun; financën &amp; kontabilitetin; agroturizmin, bioteknologjinë dhe ushqimin; industrinë e pijeve; mbarëshkrimin e pyjeve; industrie drurit; mjekësi veterinarë &amp; shëndet publik", fusha thelbësore të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit,</p>

	<p>të cilat mbështeten dhe zhvillojnë më tej vlerat akademike dhe kulturore kombëtare.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga UBT, janë një pjesë e rëndësishme unike me vlerë strategjike për ekonominë e vendit dhe zhvillimin e tij afatgjatë. Zhvillimi ekonomik i vendit nuk mund të arrihet pa zhvillimin bujqësor. Në këtë kontekst, ndërtimi i programit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”, garanton qëndrueshmëri, e cila konstatohet dukshëm përgjatë analizës së thelluar të treguesve, e përforcuar edhe nga gjykimet e stafit akademik.</p> <p>Programi mbështetet në vlerat kombëtare dhe në identifikimin e rrugëve të zhvillimit ekonomik e social të zonave rurale, aktiviteteve të biznesit apo administrimit të burimeve natyrore të përshtatshme me kushtet e vendit.</p> <p>GVJ, mbështetur në traditën dhe emrin e UBT si një nga institucionet më të njohura në vend dhe vazhdues i denjë i Institutit të Lartë Shtetëror të Bujqësisë, themeluar në vitin 1951, emërtuar në vitin 1991 si “Universiteti Bujqësor i Tiranës”, nëpërmjet programeve të tij, veçanërisht Bsc në “Ekonomiksi i Aplikuar”, objekt i vlerësimit, përçon vlerat akademike dhe kulturore të vendit, në përputhje të plotë jo vetëm me karakteristikat e modleit të tranzicionit nga ekonomia e centralizuar në ekonomi tregu, por çka është më thelbësorja me burimet natyrore e njerëzore si edhe mundësitë e sipërmarrjes, për një prëdorim efektiv të tyre, me qëllim rritjen ekonomike dhe zhvillimin social të vendit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;2. Statuti UBT, pdf;3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>UBT si një institucion i vetëm në llojin e tij në vend, i udhëhequr nga misioni i edukimit profesional dhe kërkimit shkencor në fushat thelbësore të zhvillimit të prodhimit bujqësor e blegtoral, të cilit i paraprijnë politikat bujqësore, të zhvillimit të integruar rural, të mbrojtjes dhe zhvillimit të agromjedisit, të harmonizuara me menaxhimin e njësive prodhuese dhe zhvillimin e tyre të qëndrueshëm, ka hartuar dhe realizon programe, të cilat garantojnë përvetësimin e dijeve dhe njohurive shumëdimensionale, në drejtimet që vijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Formimin bujqësor në drejtim të zhvillimit të bujqësisë modernë dhe garantimit të ushqimit të shëndetshëm dhe cilësor.</li> <li>▪ Mbështetjen e rrugëve inovative për të përmirësuar të mësuarit gjatë gjithë jetës si përmes traditës ashtu dhe përmes teknologjive të reja.</li> <li>▪ Ndërgjegjësimin të shoqërisë mbi nevojën e ruajtjes dhe zhvillimit të burimeve natyrore dhe mjedisit.</li> </ul> <p>GVJ vlerëson se programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” në ciklin e parë të studimeve, si pjesë e Departamentit të Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural (DEPZHR), hartohet dhe ofrohet në</p>

	<p>përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së institucionit si edhe me qëllimin dhe misionin e tij.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;2. Statuti UBT, pdf;3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Arsimi i Lartë Bujqësor është mjet që garanton përfitimin, përvetësimin dhe përhapjen e njohurive në fushën e bujqësisë, mbarështrimit të qendrushëm të pyjeve, zhvillimit rural të qendrushëm, agroturizmit, mirëmenaxhimit të burimeve mjedisore, ushqimit, etj. Në përputhje të plotë me këtë vizion, të shprehur edhe në planin strategjik të UBT, ky program studimi synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Trasmetimin e lirë të njohurive për të ndikuar në ndërtimin e një shoqërie të civilizuar dhe të hapur që mbështetet mbi zhvillimin e konkurrencës së tregut dhe përfshirjen sociale.</li> <li>▪ Garantimin e cilësisë në arsim, në përputhje dhe zbatim të ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në përgjigje të sfidave kombëtare dhe rajonale.</li> <li>▪ Realizimin e përgjegjësive që burojnë nga procesi i Bolonjës.</li> <li>▪ Plotësimin e nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve në tregun lokal dhe global të punës.</li> </ul> <p>Mbështetur në sa më lart, GVJ gjykon se programi i studimit është hartuar dhe ofrohet për të nxitur zhvillimin e përgjithshëm ekonomik kombëtar, si edhe për të kontribuar në realizimin e objektivit strategjik politik të integritetit të vendit në BE.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;2. Statuti UBT, pdf;3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b></p> <p><b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” është hartuar dhe ofrohet nga departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural. Rregullorja e departamentit si edhe rregullorja e programit “Ekonomiks i Aplikuar” përcaktojnë qartë objektivat e programit të “Ekonomiksit të aplikuar”, si një program që synon përgatitjen e vendimmarrësve, menaxherëve dhe studjuesve të ekonomisë me drejtim zhvillimin bujqësor.</p>

	<p>GVJ gjykon që ky program përputhet plotësisht me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit, e cila i kushton vëmendje të veçantë gjetjes së mënyrave novatore për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ofrimin e njohurive dhe dijeve bashkëkohore, për të realizuar objektivat e institucionit, dhe përtej tyre kontribuar në realizimin e objektivave të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf;]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti i Institucionit, Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e programit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike, në të cilat saktësohet Njësia bazë si një qendër bashkëkohore studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive, për t’u bërë pjesë integrale e një bote, ku studentët e diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit të gjejnë veten e tyre dhe të kontribuojnë me dije e profesionalizëm në fushat e ekonomisë bujqësore, zhvillimit rural të integruar, menaxhimit të ndërmarrjeve, financës, kontabilitetit, marketingut, agroturizmit, ekonomisë dhe politikave agrare etj., në kuadër të integritimit Evropian të vendit.</p> <p>Program i studimeve të nivelit të parë, Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” është pjesë e aksit prioritar akademik të “ekonomisë bujqësore” të listuar në vizionin e FEAs.</p> <p>Nevoja për të ndjekur me përparësi drejtim të ri të zhvillimit të Njesisë bazë dhe programit të saj, ka qenë edhe arsyeja themelore e transformimit të programit të mëparshëm “Politika Agrare”. Ndryshimi i emërimit, i realizuar pas një diskutimi të gjatë mbështetet tek koncepti i zhvillimit rural që përfshin jo vetëm politikën agrare, por edhe institucionet.</p> <p>Nisur nga koncepti i ri që nuk e konsideron zhvillimin e bujqësisë vetëm si sektor, por përfshin edhe organizimin dhe mirëadministrimin e territorit, programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” synon të ofrojë njohuritë që udhëheqin profesionistët drejt zgjidhjeve më efektive dhe gjithëpërfshirëse, argumentim të cilin GVJ e konsideron jo vetëm të arsyeshëm, por edhe efektiv.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 18.1. Vendim i Këshillit të Fakultetit për ndryshimin e emrit të departamentit.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit përputhet plotësisht me drejtimit themelore akademike të institucionit. Siç nënvizohet edhe tek Rregullore e brendshme e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (Rregullore e brendshme e FEAs, 2017, neni 19, pika 3), të gjitha programet e studimit janë bashkëkohore, plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe europiane, si edhe të harmonizuara në fusha që plotësojnë njëra-tjetrën.</p>

	<p>Programet janë të organizuara dhe mundësojnë ndjekjen dhe përfundimin e të gjitha cikleve të studimit, përparësi e Fakulteti të Ekonomisë dhe Agrobiznesit.</p> <p>Programet e studimit të ciklit të parë (bachelor) në fushën e shkencave të ekonomisë bujqësore mundësojnë ndjekjen e studimeve dhe diplomimin në fushat që vijojnë, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Menaxhim Agrobiznesi,</li> <li>▪ Ekonomi dhe Politikë Agrare,</li> <li>▪ Financë – Kontabilitet,</li> <li>▪ Menaxhim i Turizmit Rural,</li> <li>▪ Ekonomiks i Aplikuar,</li> <li>▪ Informatikë Biznesi.</li> </ul> <p>Programi i studimit i ciklit të parë, Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit Rural, sëbashku me programin e “Ekonomiks i Politikave të Zhvillimit Rural”. Ky departament, një nga departamentet thelbësore të fakultetit, nëpërmjet njohurive bashkëkohore dhe të organizuara në struktura po të tilla, siguron përgatitjen e specialistëve të ekonomisë, njëherazi edhe agjentë të zhvillimit rural, specialitet i kërkuar dhe vlerësuar në treg.</p> <p><i>[Referenca: 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 18.1. Vendim i Këshillit të Fakultetit për ndryshimin e emrit të departamentit.pdf]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi I.3</b></p> <p><b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i ciklit të parë të studimeve Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”, synon të përgatisë profesionistë të fushave të vendimmarrjes, menaxherë dhe kërkues shkencorë të fushës së ekonomisë të zhvillimit rural, nëpërmjet formimit të shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë specialitetesh si: menaxher financiar, ekonometricien/statisticien, analist tregu/analist biznesi, ekonomist agrar, analist tregu, analist marketing, ekonomist i mjedisit dhe burimeve natyrore, etj., udhëhequr nga arritja e objektivave që vijojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të përgatisë specialistë të aftë në fushën e ekonomiksit të aplikuar, nëpërmjet njohjes së thellë teorike, përdorimit të</li> </ul>

	<p>metodave sasiore të programimit të studimit si edhe formimit të qëndrueshëm profesional.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të pajisë specialistët me instrumentat, teknikat dhe metodat më bashkëkohore, përmes të cilave ofrohen zgjidhje për sfidat e sektorit publik dhe privat të ekonomisë.</li> <li>▪ Të pajisë specialistët me njohuritë më bashkëkohore në fushën e kërkimit, me qëllim mundësimin e një kualifikimi më të avancuar shkencor për nivelet e tjera të studimit në financë dhe menaxhim, apo edhe në fusha me karakter të veçantë si ekonomiks bujqësor, zhvillim rural i integruar dhe menaxhim mjedisor i turizmit.</li> </ul> <p>Mbështetur në sa u përshkrua më lart, GVJ gjykon që jo vetëm objektivat e programit janë të përcaktuara qartë, por edhe të ndërtuara në përputhje me nevojën duke ndikuar në formimin bashkëkohor dhe të përshtatshëm të studentëve, nëpërmjet ofrimit të njohurive të mirëharmonizuara teorike dhe praktike dhe transmetimit të dijeve, të cilat ndikojnë sa në rritjen e aftësive aq edhe në zhvillimin e kompetencave profesionale në përputhje me kërkesën e tregut për këtë program.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Njësia bazë kryen studime të rregullta mbi tregun e punës. Studimi i fundit i tregut i përket vitit 2018. Studimi i tregut i parapriu propozimit për ndryshimin e emërtimit të departamentit në vitin 2012 si edhe propozimit për hapjen e programit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”. Studimet e tregut, të realizuara mbi metoda sasiore dhe cilësore kanë shërbyer për të orientuar njësinë bazë drejt vendimmarrjes së saj.</p> <p>Njësia bazë gjithashtu ka përdorur edhe evidenca dhe të dhëna të institucioneve të tjera, si psh studime të INSTAT. Rezultatet e studimeve mbi zhvillimin e tregut kanë udhëhequr njësinë bazë drejt:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ofrimit të një game të gjerë të njohurive dhe dijeve tek bujqësia, rrjedhojë e rritjes së vëmëndjes së përgjithshme mbi politikat ekonomike dhe të zhvillimit rural.</li> <li>▪ Zgjerimit të hapësirave për praktikat profesionale, të cilat lehtësojnë tranzicionin e studentëve nga shkolla në tregun e punës.</li> <li>▪ Rritjes së numrit të lëndëve të orientuara tek “Aftësitë”.</li> <li>▪ Aktivizimit të studentëve në projekte (siç është projekti GRADUA), të cilat nxisin studentët drejt tregut të punës.</li> </ul> <p>Studimet mbi tregun e punës zhvillohen në mënyrë periodike (2012, 2017, 2018) me qëllim përthithjen e informacioneve të përditësuara,</p>



	të cilat orientojnë riorganizimin dhe përmirësimin e programit studimor. <i>[Referenca:2. Statuti UBT, pdf; 24. Studim tregu 2012.pdf; 25. Studim tregu, 2017.pdf; Studim tregu, 2018.pdf]</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	GVJ gjykon që struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është drejtëpërsëdrejti e lidhur me rezultatet konkrete, të demonstruara nëpërmjet: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rritjes së numrit të aplikimeve dhe pranimeve në Programin e ciklit të parë, Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”.</li> <li>2. Integritimit të studentëve në tregun e punës.</li> <li>3. Rezultatet e përpunimit të anketave të studentëve (realizohen dy anketa në vit)</li> </ol> <p>Njësia bazë trajton me përparësi vëzhgimin e rezultateve të të nxënit me qëllim identifikimin e problemeve që mund të pengojnë arritjen e objektivave.</p> <p>Në gjykimin e GVJ, programi është i mirëpritur nga kërkesa, tendencë kjo e qëndrueshme gjatë viteve të fundit.</p> <i>[Referenca: 24. Studim tregu 2012.pdf; 25. Studim tregu, 2017.pdf; 26. Studim tregu, 2018.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Programi Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” ofrohet nga departamenti i “Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural”, një nga 6 departamentet e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, që nga viti 2013 në zbatim të Urdhërit Nr.208, date 31.05.2013, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ndonëse programi Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” në krahasim me Fakultetin që e ofron dhe Universitetin mund të konsiderohet relativisht i ri, Fakulteti dhe Universiteti janë nga më të vjetrit në vend dhe më me eksperiencë (UBT është vazhdues i Institutit të Lartë Shtetëror të Bujqësisë, themeluar në vitin 1951, emërtuar në vitin 1991 si: “Universiteti Bujqësor i Tiranës”).  Njësia bazë ka përvojë të mjaftueshme dhe cilësore për të ofruar këtë program, përvojë që rrjedh sa nga e kaluara dhe tradita e institucionit, aq edhe nga niveli i lartë profesional dhe kualifikimi i stafit të



	<p>angazhuar në mësimdhënie dhe bashkëpunimet me institucione të tjera të njohura jashtë vendit.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” përbëhet nga 38 pedagogë, nga të cilët vetëm 2 ose 5% janë me kohë të pjesshme. 17 pedagogë të brendshëm ose 45% e stafit mbajnë titujt Prof.Dr dhe Prof.Asoc.Dr. Vetëm 5 pedagogë, përkatësisht 3 të brendshëm dhe 2 me kohë të pjesshme mbajnë titullin Msc. 38% e stafit të përgjithshëm mban gradën shkencore Doktor ose Docent. (Lista e plotë e personelit të programit).</p> <p>GVJ gjykon që njësia bazë ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të siguruar cilësinë më të lartë në mësimdhënie.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 28.Lista e stafit të njësisë kryesore.pdf; 29. Lista e plotë emërore e personelit akademik të programit EA, 2018-2019; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” përputhet me fushat akademike kërkimore të njësisë kryesore, të cilat janë mjaft komplekse dhe të larmishme.</p> <p>Ndonëse është e vështirë të realizohet në Departamentin e Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural një ndarje e fushave midis GMK-ve, dhe aq më shumë mes prioriteteve, pasi ato janë komplekse dhe gjithë përfshirëse ashtu si është dhe vetë problematika e bujqësisë, Departamenti është i organizuar në 4 Grupe Mësimore Kërkimore, përkatësisht:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ GMK i Statistikës dhe Ekonometrisë;</li> <li>▪ GMK i Politikave Bujqësore;</li> <li>▪ GMK i Mikro dhe Makroekonomisë; si dhe</li> <li>▪ GMK i Ekonomiksit të Aplikuar.</li> </ul> <p>Ndarja e fushave të kërkimit sipas GMK-ve, është bërë për efekte studimi, pasi ato ndërveprojnë me njëra-tjetrën në kuadër të natyrës dhe objektivave të departamentit. Kjo ndarje më shumë i shërben punës me studentët për përgatitjen dhe udhëheqjen e temave të diplomave në të tre nivelet e studimit.</p> <p>Fushat kryesore të studimit të Departamentit janë gjithsej 22, nga të cilat të paktën 7, i përkasin fushës së Ekonomiksit të Aplikuar.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik konfirmoi se njësia kryesore analizon në mënyrë të vazhdueshme punën kërkimore shkencore dhe rezultatet e saj. Anëtarët e stafit akademik janë nga më</p>

	<p>të cituarit në Easyweb, me rreth 20 punime shkencore dhe artikuj në vit si edhe po aq punime të paraqitura në konferenca ndërkombëtare.</p> <p><i>GVJ gjykon se ndonëse stafi akademik ka të gjithë hapësirën e nevojshme për të ushtruar punën kërkimore shkencore dhe është fuqimisht i motivuar për të realizuar kërkime të cilësishme, sigurimi i mbështetjes financiare mbetet një nga sfidat më kritike.</i></p> <p><i>Centralizimi i veprimtarisë së institucionit, karakteristikë e institucioneve publike, jo rrallë e përball veprimtarinë shkencore me sfida kritike.</i></p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017, pdf; 44. Analiza mësimore e FEAs, 2017-2018.pdf; 46. Analiza mësimore shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; 47. Analiza kërkimore DEPZHR, 2018.pdf]</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga vizita në Institucion, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”, Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe angazhuar staf të kualifikuar. Një pjesë e lëndëve bazë të programit mbulohen nga stafi i Departamentit (75%), ndërsa angazhohet staf nga departamentet e tjera të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit për lëndët e formimit karakterizues dhe lëndë plotësuese.</p> <p>Programi i studimit BSc në “Ekonomiks i Aplikuar” lejon bashkërendim të stafit në disa disiplina formimi, si ekonomiksi, financa dhe kontabiliteti, menaxhim turizmi rural apo agrobiznesi. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikqyret nga instancat drejtuese të UBT duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, ZSCVI etj.</p> <p>Çdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës së njësive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UBT-së.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf;]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni për hartimin, mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi, por këto marrëdhënie janë ngritur kryesisht në rang fakulteti. Qendra e Karrierës dhe Alumni, institucioni përgjegjës, ka ndërmjetësuar rreth 43 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës (sipërmarrje, institucione publike, OJF), të cilët japin një kontribut tepër të vyer për lehtësimin e tranzicionit të studentëve nga studimi në tregun e punës, nëpërmjet realizimit të praktikave mësimore.</p> <p>Marëdhëniet e bashkëpunimit që lindin si rrjedhojë e pjesëmarrjes në projekte janë gjithashtu të rregulluara nga pikëpamja institucionale, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të dokumentit “Rregullore mbi përpilimin dhe menaxhimin e projekteve në UBT”, e miratuar nga Senati në vitin 2018 (e përditësuar).</p> <p>Në përputhje me rregulloren, të gjitha departamentet dhe të gjithë anëtarët e stafit mund të përfshihen në bashkëpunime nëpërmjet projekteve, nëse kualifikimi i tyre profesional përputhet me kërkesat e projektit. Ndonëse informimi dhe menaxhimi i përgjithshëm i projektit koordinohet nga zyra e Rektorit ose Dekanatit, departamentet mbajnë peshën kryesore në hartimin dhe zbatimin e projektit.</p> <p>Njësia kryesore ka siguruar bashkëpunime të qenësishme të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në zhvillimin dhe rritjen e programit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”. Njësia kryesore ka bashkëpunim të qëndrueshëm me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet të cilit realizohet kualifikimi i stafit të ministrisë.</p> <p>Gjithashtu, njësia kryesore është partner bashkëpunues edhe i projekteve të rëndësishme të qeverisë, të cilat synojnë realizimin e prioritetëve strategjike si psh projekti i Reformës Territoriale.</p> <p><i>Megjithatë GVJ gjykon që decentralizimi i aktivitetit, të paktën i marrëdhënieve me të tretët, do të siguronte më shumë hapësirë bashkëpunimi dhe do të rriste efektivitetin e këtyre bashkëpunimeve.</i></p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 36. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit.pdf; 37. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe-shembull marrëveshje.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Megjithëse në nivel universiteti, analiza e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit është objekt diskutimi, njësia përgjegjëse për programin do të ishte e inetresuar të analizonte përfitimet në fushën e saj të interesit. Megjithatë kjo analizë nuk mund të realizohet nga njësia përgjegjëse për programin, sepse institucioni menaxhohet kryesisht në mënyrë të centralizuar.</p> <p>Njësia përgjegjëse për programin raporton, por nuk analizon në mënyrë të pavarur sepse marrëveshjet nuk janë sektoriale. Sidoqoftë, njësia përgjegjëse është pjesë e analizës vjetore.</p>

	<p>GVJ konstaton gjithashtu se çështja e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit nuk analizohet si tematikë e veçuar, por në kuadrin e përgjithshëm të analizës vjetore.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 36. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të arritura nga institucioni (43 marrëveshje), Njësia përgjegjëse për programin mundëson realizimin e praktikave të studentëve. GVJ konstaton se mbikëqyrja e praktikës gjithashtu realizohet në mënyrë të institucionalizuar në sajë të dokumentacionit tip të parapërgatitur (kontratë tip) i cili plotësohet nga mbikëqyrësi përgjatë realizimit të praktikës mësimore.</p> <p>Institucioni ka vendosur zgjatjen e praktikës mësimore në një semester, e cila mundësohet në sajë të marrëdhënieve të gjera dhe të larmishme të bashkëpunimit. Çdo vit, 25 deri 30 studentë realizojnë praktikën mësimore tek INSTAT.</p> <p>Takimi me studentët konfirmoi vlefshmërinë e praktikave mësimore, të cilat ju shërbejnë atyre për të fituar shprehitë e para të punës praktike si edhe njohjen me tregun e punës.</p> <p>GVJ vlerëson se në drejtim të praktikave mësimore, rrjeti i bashkëpunimeve të njësive përgjegjëse për programin, përbën një përparësi.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 70. Programi i praktikës.pdf; 71. Formulari dhe kontrata e praktikës profesionale.pdf; 84. Monitorimi i praktikave profesionale Bachelor.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” synon arsimim shkencor e profesional të studentëve në fushën e vlerësimit të zhvillimit ekonomik dhe të politikave të zhvillimit rural, duke pajisur studentët me njohuritë themelore të fushës.</p> <p>Programi është hartuar për të përgatitur profesionistë të fushës së vendimmarrjes, menaxherë dhe studiues të fushës së ekonomisë me fokus zhvillimin bujqësor. Ky program është I vlerësuar dhe I kërkuar nga tregu si pasojë e rëndësisë që ka zhvillimin rural në ekonominë shqiptare.</p> <p>Në funksion të këtij qëllimi institucioni angazhon zyrat mbështetëse si Zyra e Karrierës dhe Zyra Alumni për mbajtjen e marrëdhënieve me studentët përmes gjurmimit të tyre si instrument vlerësues për kërkesat e tregut dhe njëkohësisht për pozicionimin e institucionit. Megjithë vështirësitë e shumta që Zyra e Alumni përballet në gjurmimin e të diplomuarve, ajo është në mbështetje të studentëve dhe pas përfundimit të studimeve. Organizimi i panairit të punës çdo vit dhe takimet me bizneset kanë qënë ndër aktivitetet e organizuara prej saj ku kanë marrë pjesë dhe studentë të diplomuar.</p> <p><i>GVJ konstaton që departamenti nuk kryen trajnime të studentëve pas diplomimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit është hapur me UMASH nr. 208 datë 31.05.2013, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 460 datë 03.05.2013, me emërtimin Bachelor në "Ekonomi dhe Agrobiznes" me profile": a. Ekonomiks i Aplikuar; b. Informatikë Biznesi, si program studimi i ciklit të parë, dhe realizohet me 180 kredite me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Ky licencim u mbështet mbi vendimin e Rektoratit, Nr.43 datë 26.12.2012 dhe Senatit, Nr.39 datë 27.12.2012, të cilët konsideruan Vendimin e Këshillit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Nr. 13, date 23.11.2012, sipas propozimit të dekanatit të FEAs.</p> <p>Me urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 586, datë 18.12.2019 ndryshon pika 1 e urdhërit nr. 208, datë 31.05.2013, dhe 2 profilet hapen si <b>2 programe të ndryshme Bachelor</b>.</p> <p>Akreditimi: Ky program akreditohet për herë të parë</p> <p>Urdhëri për aprovimin e modelit të Diplomës Nr. 405, datë 08.09.2017, i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka akoma emërtimin e vjetër të programit: "Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në "Ekonomi dhe Agrobiznes", profili Ekonomiks i Aplikuar".</p> <p>GVJ gjykon që Programi i studimit Bsc në "Ekonomiks i Aplikuar" plotëson në tërësi kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e ekonomisë, rritjes së kërkesës për profesionistë në fusha të ndryshme të aktiviteteve ekonomike, organizimit dhe administrimit me një staf të kualifikuar, mësimdhënies e mësimnxënies për realizimin me cilësi të programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga "Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) (5 lëndë/29 ECTS), Lëndë Karakterizuese (17 lëndë /90 ECTS), Lëndë ndërdisiplinore ose/dhe integruese si edhe me zgjedhje (6 lëndë/ 26 ECTS), Lëndë Plotësuese (3 lëndë, ku është e përfshirë edhe Praktika profesionale mësimore/16 ECTS, ndërsa i gjithë grupi ka 26 ECTS) si</p>



	<p>edhe Diploma/Provimi Përgjithshëm Përfundimtar / 9 ECTS, gjithsej 180 ECTS.</p> <p>Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e një provimi të përgjithshëm formimi ose të përgatitjes dhe mbrojtjes të një punimi diplome, në varësi të notës mesatare të dy viteve të para të studimit.</p> <p>Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>GVJ gjithashtu vlerëson se përbërja e programit është në përputhje me nevojat e tregut, rrjedhë e analizës së kujdesshme të njësisë përgjegjëse për programin. GVJ konsideron përparësi zgjatjen e praktikës mësimore në 12 javë, e cila vlerësohet edhe nga studentët si një instrument i dobishëm për tranzicionin e tyre nga shkolla në tregun e punës.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 19. Vendim i FEAs për çeljen e profilit Ekonomiks i Aplikuar, 23.11.2012.pdf; 20. Vendim i Rektoratit dhe i Senatit për hapjen e profilit Ekonomiks i Aplikuar.pdf; 21. Urdhër i Ministrisë për hapjen e programit, 31.05.2013.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf; 69. Vendim për kohëzgjatjen mësimore të praktikës profesionale.pdf].</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ, pasi analizoi programin e studimit, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe pas diskutimeve me stafin akademik të institucionit, gjykon që programi që vlerësohet realizon formimin e shprehive të veçanta dhe aftësimin e profesionistëve të ardhshëm me qëllim që t’iu përgjigjet më mire nevojave të tregut, mbështetur edhe në eksperiencën e institucionit, i cili është një nga institucionet më të njohura në vend dhe i vetëm në llojin e tij.</p> <p>Prej vitit 2012, njësia kryesore ofron programin e studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” si Diplomë e veçantë. Hapja e këtij program është udhëhequr nga analiza e nevojave të tregut kryesisht, analiza frekvente që sigurojnë të dhëna të përditësuara.</p> <p>Programi në ciklin e parë, Bachelor synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të përgatisë specialistë të aftë në fushën e ekonomiksit të aplikuar, nëpërmjet njohjes së thellë teorike, përdorimit të metodave sasore të programimit të studimit si edhe formimit të qëndrueshëm profesional.</li> <li>▪ Të pajisë specialistët me instrumentat, teknikat dhe metodat më bashkëkohore, përmes të cilave ofrohen zgjidhje për sfidat e sektorit publik dhe privat të ekonomisë.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të pajisë specialistët me njohuritë më bashkëkohore në fushën e kërkimit, me qëllim mundësimin e një kualifikimi më të avancuar shkencor për nivelet e tjera të studimit në financë dhe menaxhim, apo edhe në fusha me karakter të veçantë si ekonomiks bujqësor, zhvillim rural i integruar dhe menaxhim mjedisor i turizmit.</li> </ul> <p>Përcaktimi i rezultateve të të nxëniet në programet mësimore (syllabuset e lëndëve) të secilës lëndë, ndihmon vlerësimin e arritjeve të studentëve në drejtim të formimit të shprehive të veçanta.</p> <p>GVJ gjykon që programi garanton llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh, sepse njohuritë e ofruara janë të larmishme dhe njëherazi unike.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ konstaton se programi Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” ofron njohuri të përparura në fushën e studimit, përfundim i cili mbështetet nga pesha e lëndëve të disiplinave karakterizuese (50%) si edhe nga larmishmëria e tyre. Lëndët karakterizuese përfshijnë thuajse të gjitha fushat në të cilat aplikohet ekonomiks si: Hyrje në Ekonomiks in e Prodhimit Bujqësor, Ekonomiks i Burimeve natyrore dhe ambientit, Ekonomiks i Publik, Ekonomiks i Punës, Zhvillimi rural i qendrueshëm, Ekonomiks i Drejtimit dhe Ekonomiks i Ndërkombetar.</p> <p>Të njëjtin këndvështrim kanë edhe studentët e regjistruar në këtë program. Lëndët e përfshira në këtë program, përmbajtja e tyre si edhe metoda e mësimdhënies sigurojnë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të Ekonomiksit, e cila përforçohet nga pjesëmarrja në leksione e të ftuarve, si nga fusha akademike ashtu edhe nga organizatat publike dhe politikëbërëse e operatorët e biznesit.</p> <p>Marëdhëniet dhe bashkëpunimi i qëndrueshëm me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural si edhe INSTAT ndikojnë në rritjen e cilësisë të mësimdhënies.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 19. Vendim i FEAs për çeljen e profilit Ekonomiks i Aplikuar, 23.11.2012.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i ciklit të parë synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh si menaxher financiar, ekonomist dhe analist tregu, ekonometricien/staticien, analist biznesi, analist agrar, ekonomist mjedisi dhe burimesh natyrore, ekonomist në njësitë e qeverisjes vendore etj.</p> <p>GVJ gjykon që njësia kryesore është e paisur me të gjitha instrumentat dhe kapacitetet e nevojshme që të realizojë programet e studimit të ciklit të parë, të tilla që zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushat akademike dhe profesionale të renditura më lart.</p>



	<p>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 28. Lista e stafit të njësisë kryesore.pdf; 29. Lista e plotë emërore e personelit akademik të programit EA, 2018-2019; 31. Lista e CV-ve të pedagogëve të angazhuar.pdf]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit i ciklit të parë, që vlerësohet, respekton me rreptësi strukturën e programit të studimit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- (A) Disiplina të formimit të përgjithshëm, bazë përbëjnë 16.2 %,</li> <li>- (B) disiplina karakterizuese përbëjnë 50%,</li> <li>- (C) disiplina të ngjashme ose/dhe integruese / lëndët me zgjedhje 14.4%,</li> <li>- (D) Lëndët plotësuese 14.4 %, ku Praktika profesionale përbën 8%).</li> <li>- (E) Detyrimet përmyllëse 5%.</li> </ul> <p>Pra lëndët janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41.</p> <p>GVJ konsideron përparësi ndryshimin në kohëzgjatjen e praktikës mësimore profesionale nga 6 në 12 javë sepse rrit mundësitë e studentëve për të njohur dhe përvetësuar konceptet praktike të profesionit. Fakti që njësia bazë arrin të realizojë praktikat në institucione dhe operatorë biznesi, dëshmon jo vetëm për përpjekjet e institucionit për të forcuar lidhjet e studentëve me tregun e punës, por edhe rrit mundësitë e studentëve për ndërtimin e një kariere të sukseshme.</p> <p>[Referenca: 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” është i organizuar në module të formimit të përgjithshëm, të formimit karakterizues, të ngjashëm dhe/ose integrues si edhe module formuese me zgjedhje, përveç praktikës mësimore profesionale dhe përgatitjes së diplomës, të cilat e kanë të përcaktuar qartë përmbajtjen e tyre, mënyrën e organizimit si edhe format e mësimdhënies.</p> <p>GVJ gjykon që program i studimit që vlerësohet, nëpërmjet veprimtarive formuese të tij, ndikon në arritjen e objektivave akademike të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.2</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë, “Universiteti Bujqësor i Tiranës” është universiteti më i vjetër në Shqipëri, themeluar më 1 Nëntor, 1951. UBT ka funksionuar fillimisht si Instituti i Lartë Shtetëror Bujqësor dhe më tej përgjatë historisë së funksionimit të tij, i është akorduar statusi i Universitetit (viti 1991). UBT është një qendër unike e arsimit të lartë në Shqipëri.</p> <p>Universiteti Bujqësor i Tiranës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 11, datë 07.04.2017 për akreditimin institucional të Universitetit Bujqësor të Tiranës, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 06.04.2021.</p> <p>Programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural.</p> <p>Sipas të dhënave për vitet 2017-2018 dhe 2018-2019 (Lista e plotë e personelit 2018-2019, Analiza mësimore 2017-2018), stafi i njësive bazë përbëhet nga 26 pedagogë (25 pedagogë për vitin 2017-2018) me kohë të plotë nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 Prof. Dr.</li> <li>- 10 Prof. Asoc. Dr.</li> <li>- 9 Dr (8 Dr për vitin 2017-2018),</li> <li>- 3 Msc</li> </ul> <p>Këta pedagogë janë të organizuar në 4 Grupe kërkimore mësimore (GMK) përkatësisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>i) GMK Politikat Bujqësore (5 anëtarë): 2 kategoria profesor, 2 Dr dhe 1 Msc);</li> <li>ii) GMK e Mikro-Makroekonomisë (8 anëtarë): 5 kategoria profesor, 2 Dr, dhe 1 Msc,</li> <li>iii) GMK e Statistikë Ekonometri (6 anëtarë): 3 kategoria Profesor, 3 Dr</li> <li>iv) GMK e Ekonomiksit të Aplikuar (6 anëtarë): 4 kategoria profesor, 1 Dr, 1 Msc.</li> </ol> <p>Në ndihmë të departamentit është i punësuar dhe një anëtar i stafit ndihmës jo akademik. Gjithashtu pranë departamentit është e atashuar një punonjëse kërkimore në kuadër të një projekti.</p> <p>Por, të dhënat e stafit të departamentit për vitin akademik 2019-2020 dëshmojnë se departamenti përbëhet nga 18 pedagogë, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 Prof.Dr,</li> <li>- 8 Prof.As,</li> <li>- 5 Dr/Doc dhe</li> <li>- 2 Msc.</li> </ul>
--	--

	<p>GVJ gjykon që njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Megjithatë, në lidhje me diferencën e theksuar prej 8 pedagogë nga viti 2018-2019 në vitin 2019-2020, Njësia bazë duhet të shpjegojë arsyet e këtij ndryshimi apo largimi.</p> <p>[Referenca: 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 28. Lista e stafit të njësisë kryesore.pdf; 29. Lista e plotë emërore e personelit akademik të programit EA, 2018-2019; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Njësia kryesore i kushton rëndësi të veçantë përgatitjes së dokumentacionit i cili udhëheq veprimtarinë e institucionit. Shqyrtimi i dokumentacionit të Njësisë bazë, veçanërisht i rregullores së departamentit dhe rregullores së programit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”, konfirmoi se njësia bazë konsideron Përgjegjësin e Departamentit, përgjegjës për çdo program studimi.</p> <p>Ndjekja dhe mbarëvajtja e programit mësimor është detyrim dhe kompetencë e Përgjegjësit të Departamentit, i cili është edhe koordinatori i programit. Njëkohësisht, koordinatori i programit ndjek edhe praktikat mësimore profesionale.</p> <p>GVJ gjykon që njësia bazë mund të rivlerësojë pozicionimin e Përgjegjësit të departamentit si Koordinator i programit, me qëllim shpërndarjen e përgjegjësi si edhe decentralizimin e funksioneve, akademike dhe administrative.</p> <p>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf;]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin si edhe gjerësisht diskutoi me stafin akademik dhe drejtuesit e Njësisë Bazë, gjykon që Njësia bazë, përgjegjëse për programin që vlerësohet, i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Struktura akademike përputhet plotësisht me misionin, qëllimin dhe objektivat e Programit që vlerësohet. Organizimi i saj mbështet plotësisht aktivitetin akademik si edhe operacional.</p> <p>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; ; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në tabelën “Lista e stafit të njësisë kryesore &amp; e njësisë përgjegjëse” lidhur me personelin akademik të përfshirë në zhvillimin e programit të studimit Bachelor në "Ekonomiks i Aplikuar" gjatë vitit akademik 2018-2019”, rezulton se stafi i njësisë bazë përbëhet nga 26 pedagogë me kohë të plotë nga të cilët 14 të kategorisë profesor (4 anëtarë me titull Prof. Dr. dhe 10 anëtarë me titullin Prof. Asoc. Dr.), 9 pedagogë me gradën Doktor Shkencash, dhe 3 anëtarë me kualifikimin Master i Shkencave.</p> <p>Nëse konsiderohen të dhënat e vitit 2019-2020 rezulton se departamenti përbëhet nga 18 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 11 të kategorisë</p>

	<p>profesor (3 Prof.Dr dhe 8 Prof.As), 5 pedagogë me gradën Doktor shkencash dhe 2 me kualifikimin Master i Shkencave.</p> <p>Programi Bsc “Ekonomiks i Aplikuar” realizohet nga 38 pedagogë (të dhënat 2019-2020), nga të cilët vetëm 2 ose 5% janë me kohë të pjesshme. 17 pedagogë të brendshëm ose 45% e stafit mbajnë titujt Prof.Dr dhe Prof.Asoc.Dr. Vetëm 5 pedagogë, përkatësisht 3 të brendshëm dhe 2 me kohë të pjesshme mbajnë titullin Msc. 42% e stafit të përgjithshëm mban gradën shkencore Doktor ose Docent.</p> <p><i>GVJ gjykon se Njësia Kryesore përgjegjëse për programin përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Sidoqoftë duhet të sqarohet se cili informacion është i saktë, përkatësisht 2018-2019 apo 2019-2020. Në rast se të dy informacionet janë të sakta, atëhere duhet të shpjegohen arsyet e ndryshimit.</i></p> <p><i>[Referenca: 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 28. Lista e stafit të njësisë kryesore.pdf; 29. Lista e plotë emërore e personelit akademik të programit EA, 2018-2019; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Siç rezulton nga dokumentat themelore rregullatore të hartuara nga institucioni dhe njësia bazë, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë ndërtuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi (Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 208, datë 31.05.2013, Vendim i Rektorit Nr.43, datë 26.12.2012, Propozim i Këshillit të Fakultetit, Nr.13, datë 23.11.2012).</p> <p>Njësia bazë, Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural, përgjegjës për programin Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”, disponon informacionet e nevojshme, si ato që transmetohen nga strukturat eprore institucionale ashtu edhe ato që hartohen brenda departamentit, në përputhje me organigramën dhe organizimin hierarkik të prodhimit dhe qarkullimit të informacionit.</p> <p>Legjislacioni udhëheqës (Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave) për veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, analizohet në Rektorat dhe mbi këtë bazë, hartohen dokumentat kryesore rregullatore në nivel fakulteti dhe më tej, departamenti. Ky dokumentacion përfshin vendime të brendshme, udhëzime, rregullore si edhe statuti, të cilat vijjnë të protokolluara dhe sipas afateve nga rektorati, përcillen në dekanat, i</p>

	<p>cili realizon detyrat e tij, duke miratuar rregulloret përkatëse dhe përcjellë informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet.</p> <p>Rregullorja e brendshme e departamentit (miratuar nga Dekani, data mungon, si edhe viti i miratimit është i paqartë nëse është 2017 apo 2018) si edhe Rregullorja e Programit “Ekonomiks i Aplikuar” (miratuar në mbledhjen e dekanatit, datë 20.09.2017) përcaktojnë gjithashtu marëdhëniet e departamentit me studentët.</p> <p><i>GVJ konstaton se ndonëse njësia bazë qartësisht i kushton vëmëndje përgatitjes së dokumentacionit rregullator dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj institucionale nga legjislacioni, disa dokumenta rregullatore nuk janë të protokolluara, data e miratimit nuk është e përcaktuar, ndërsa vërehet edhe mospërputhje në kohë (Rregullorja e Programit Bsc në Ekonomiks i Aplikuar është miratuar përpara Rregullores së brendshme të fakultetit).</i></p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 18.1. vendim i Këshillit të Fakultetit për ndryshimin e emrit të departamentit.pdf; 19. Vendim i FEAs për çeljen e profilit Ekonomiks i Aplikuar, 23.11.2012.pdf; 20. Vendim i Rektoratit dhe i Senatit për hapjen e profilit Ekonomiks i Aplikuar.pdf; 21. Urdhër i Ministrisë për hapjen e programit, 31.05.2013.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar mbi synimet dhe objektivat e programit të studimit, të paraqitura tek “Dosja e plotë e hapjes së programit, Plani mësimor 2018-2019, si edhe Rregullorja e Programit, lehtësisht konstatohet rëndësia dhe vëmëndja që i kushton departamenti formimit të duhur sipas lëndëve të kategorizuara sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Programin që po vlerësohet, është organizuar: 29 ECTS ose 16.2 %, lëndë bazë (kategoria A); 90 ECTS ose 50%, lëndë karakterizuese (kategoria B); 26 ECTS ose 14.4%; lëndë integruese, ndërdisiplinore dhe me zgjedhje (kategoria C), 26 ECTS ose 15%, lëndë plotësuese (kategoria D) dhe 9 ECTS ose 5%, detyrime përmbyllëse (kategoria E). Kategoria C është e organizuar si kombinim I 3 lëndëve ndërdisiplinore (12 ECTS) dhe 3 lëndë me zgjedhje nga 8 alternativa, 14.4 ECTS. Tek lëndët plotësuese, kategoria D, vend thelbësor zë “Praktika mësimore profesionale”, 16ECTS.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit është organizuar në përputhje me specifikimet ligjore.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”, bazohet në sistemin e vlerësimit me kredite ECTS, sistem i cili është pranuar gjerësisht në nivel Evropian dhe në nivel kombëtar, në përputhje me kartën e</p>



	<p>Bolonjës, duke krijuar mundësinë e krahasimit të ngarkesës së nevojshme për realizimin e secilës lëndë që përbën një program studimi.</p> <p>Programi i studimit realizohet në 3 vite akademike ose 6 semestra me një total prej 180 ECTS, 60 ECTS për secilin vit akademik. Një semester përmban 15 jave mësimore ose 30 ECTS.</p> <p>Kreditet e secilës lëndë së bashku me peshën specifike të grup lëndës (përqindja ndaj totalit) ndihmojnë studentin të kuptojë ngarkesën e përgjithshme, vjetore dhe atë semestrale.</p> <p>Ai gjithashtu pasqyron kritere për kalimin e të gjitha provimeve si edhe instrumentin për të vëzhguar ecurinë e studentit nga një vit akademik tek tjetri, deri në përfundimin e plotë të studimeve.</p> <p>Konkretisht ndarja në semestra konsideron një shpërndarje relativisht të barabartë të ngarkesës mësimore, ku lëndët bazë dhe ato karakterizuese, tek të cilat dominojnë lëndët 4 dhe 5 kredite, janë të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme ndërmjet semestrave të secilit vit akademik.</p> <p>Lëndët dhe shpërndarja e tyre me kreditet, orët mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, që zënë modulet e kategorive të ndryshme janë në zbatim të Vendimit nr 41, date 24.01.2018, udhëzimeve të MASR dhe rregulloreve të institucionit dhe programit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017, pdf; 44. Analiza mësimore e FEAs, 2017-2018.pdf; 46. Analiza mësimore shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” është i mbështetur në Planin Strategjik të UBT, 2016-2025 si edhe në Planet mësimore vjetore. Në këto dokumenta përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor në Ekonomiks i Aplikuar. Në këtë plan, ngarkesa e një viti akademik (60 ECTS) është llogaritur 1.500 orë, (60 ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.</p> <p>Gjithashtu, Njësia Bazë ka përcaktuar të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me frekuentimin, ndjekjen e programit si edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Këto element përveç se të përcaktuara në Rregulloren e departamentit (standardet bazë), Rregulloren e programit, janë gjithashtu të përcaktuara në syllabusin e secilës lëndë.</p> <p>Vlerësimi i dijeve të studentit ndahet në vlerësim të vazhduar dhe vlerësim përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar, në varësi të lëndës varion nga 25% - 50% të totalit të pikëve dhe konsiston në dy elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Aktivizimi dhe pjesëmarrja në seminare;</li> <li>▪ Testi i ndërmjetëm (detyra kontrolli) dhe detyra e kursit.</li> </ul>

	<p>Frekuentimi leksioneve dhe i seminareve në këtë program studimi është i detyrueshëm në masën 80% ndërsa frekuentimi i praktikave/ laboratorëve është i detyrueshëm në masën 100%.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Njësia bazë ka përpunuar informacione të detajuara, të cilat ju përcillen studentëve nëpërmjet disa dokumentave thelbësore, siç janë: Rregullorja e Programit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”, Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e brendshme e studimeve e Fakultetit si edhe Statuti i UBT.</p> <p>Këto dokumenta përcaktojnë të gjithë elementët dhe mekanizmat e duhur për të rregulluar marrëdhëniet e studentëve me institucionin, në funksion të realizimit të qëllimit të tyre si: regjistrimi, ndjekja, përfundimi i studimeve dhe diplomimi në programin e studimit, Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”.</p> <p>Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit janë në përputhje me nenin 74 të ligjit 80/2015 të arsimit të lartë, me udhëzimet e përvitshme të MASR, në kriteret e parashikuara në nenin 22 të rregullores së FEAs, si dhe me kriteret e propozuara nga njësia bazë dhe të miratuara nga senati i UBT (parimi meritë-preferencë). Procesi i pranimit të studenteve bëhet mbi bazë të një transparence të plotë, ku kriteret e pranimit, afatet, lista e kandidatëve fitues etj. shpallen në mjedise publike dhe kandidati për student ka të drejtën e ankimit në strukturat përkatëse në rast nevojë. Megjithëse kuotat e pranimit të miratuara nga MASR për këtë program studimi nuk kanë ndryshuar në tri vitet e fundit (90 studentë) konstatohet një rritje në numrin e aplikimeve nga 953 aplikime në vitin akademik 2017-2018 në 1147 aplikime për vitin e akademik 2019-2020.</p> <p>GVJ gjykon që vlen për t’u nënvizuar edhe vëmendja e institucionit në raport me procedurat e transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve. Njësia bazë është kujdesur që programi i studimit të jetë i krahasueshëm me programe të tjera të së njëjtës natyrë, kryesisht jashtë vendit, me qëllim që të lehtësojë ekuivalentimin dhe transferimin e studimeve, në përputhje me kërkesën e studentëve.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë</p>	<p>Analiza e Syllabuseve të detajuara të lëndëve (Propozim për çeljen e programit të studimit, Lista e materialeve didaktike të detyrueshme për t’u përfshirë në syllabuse, Elementët e programit të studimit) dëshmon se informacioni mbi përmbajtjen dhe formën e organizimit të mësimdhënies, për secilën lëndë të programit, është i detajuar, i plotë dhe i lehtë për t’u përdorur. Syllabusi përmban: Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, tematikën e secilës orë mësimi, formën e kontrollit të dijeve dhe literaturën. Format i</p>



<p>auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>syllabuseve përputhet me standardet e përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Syllabusi, i përgatitur nga pedagogu i lëndës, depozitohet i firmosur, tek Njësia Bazë, përpara fillimit të semestrit. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për prezantimin e syllabusit si edhe sqarimin e modaliteteve të ndjekjes së lëndës, në orën e pare të mësimt.</p> <p>GVJ konstaton se programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme në lidhje me kërkesat e kriterit 6.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Me qëllim plotësimin më të mirë të nevojave të tregut, mbështetur në studime të përditësuara të tregut, përkatësisht në vitin 2017 dhe 2018, si edhe të kërkesave të studentëve, programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” është riorganizuar (Dosja e plotë e aplikimit për çeljen e programit të studimit, Plani Mësimor 2017-2018, Plani mësimor 2018-2019), në përputhje me udhëzimet e MARS.</p> <p>Ndryshimet dhe përshtatjet e propozuara nga Njësia dhe të miratuara nga Senati, përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rivlerësim kredite të disa lëndëve, praktikës dhe diplomës.</li> <li>• Integrim të lëndëve ndërdisiplinore dhe me zgjedhje në një kategori.</li> <li>• Ndryshim emërtimi të disa disiplinave.</li> <li>• Ndryshim të ngarkesës mësimore dhe të lëndëve ndërmjet kategorive.</li> </ul> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.4</b></p> <p><b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimt të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë, në nenin 70 pika 4, përcakton mënyrën e organizimit të programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, në tre cikle të njëpasnjëshme.</p> <p>Rregullorja dhe Statuti i UBT konfirmojnë se Fakulteti Ekonomisë dhe Agrobiznesit ofron programe studimi në dy cikle, ndërsa është i gatshëm</p>

	<p>të ofrojë në ciklin e tretë si edhe Master Ekzekutiv. Ngarkesa e programit përmban 180 kredite të shtrira përgjatë tre viteve akademike, në 6 semestra, përkatësisht dy semestra në një vit akademik.</p> <p>Ngarkesa në orë mësimore dhe orë jashtë auditorit është përcaktuar tek Plani Mësimor i programit.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2019-2020, referuar “Lista e personelit akademik që është i përfshirë në zhvillimin e programit të studimit të ciklit të parë Bsc në "Ekonomiks i Aplikuar" gjatë vitit 2019-2020” (Informacion plotësues) janë planifikuar të realizohen 3690 orë gjithsej nga stafi PAE dhe PAK. Ndërsa stafi PAE ka realizuar 3630 orë ose 98% të ngarkesës së përgjithshme, stafi PAK ka realizuar vetëm 60 orë ose 2% të ngarkesës së përgjithshme.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017, pdf; 44. Analiza mësimore e FEAs, 2017-2018.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programin që po vlerësohet, Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” është ndërtuar sipas 5 drejtimeve themelore, përkatësisht Lëndë Bazë, Karakterizuese, Ndërdisciplinore dhe me zgjedhje, Plotësuese dhe Detyrime Përmblyëse, në përmbajtjen e të cilave janë klasifikuar lëndët në aktivitete formuese dhe aktivitete praktike, në funksion të programit të studimit si edhe për të rritur mundësitë e punësimit të studentëve, nëpërmjet rritjes së nivelit profesional të tyre.</p> <p>Të gjitha veprimtaritë akademike si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të arritjes të objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodatat e mësimdhënies mbështetin të mësuarit interaktiv si edhe nxitjen e mendimit të tyre krijues.</p> <p>Bashkëpunimi me organizatat e biznesit nëpërmjet të ftuarve dhe/ose vizitave mbështet tranzicionin e studentëve nga shkolla në tregun e punës. Zgjatja e praktikave mësimore nga 6 në 12 javë ka ndikuar në rritjen e efektivitetit të tyre.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 48. Udhëzues në nivel institucioni për zhvillimin dhe përdorimin e metodave innovative të mësimdhënies.pdf; Dokumente plotësuese]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>Siç konstatohet nga Plani mësimor si edhe nga diskutimet në institucion, shpërndarja e lëndëve ndërmjet viteve dhe semestrave synon të ofrojë njohuri gradualisht të përshkallëzuara. Kështu, në vitin e parë dhe të dytë ofrohen kryesisht disiplinat e njohurive të përgjithshme, ndërsa në vitin e tretë sigurohen njohuritë e detajuara profesionale.</p> <p>Planet mësimore të tre viteve të fundit si edhe dokumenta plotësuese për vitin akademik 2019-2020 sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të detajuar mbi ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor. Ngarkesa e një viti akademik (60ECTS) është llogaritur 1.500</p>

	<p>orë, (60ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017, pdf; 44. Analiza mësimore e FEAs, 2017-2018.pdf; 46. Analiza mësimore shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; Dokumente plotësuese]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Informacioni i siguruar nga shqyrtimi i Rregullores së Departamentit dhe të programit të studimit konfirmon se ky program studimi ju siguron studentëve Diplomë Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar”, në sajë të së cilës ata mund të ushtrorjnë profesionin si specialistë menaxher financiar, ekonometricien/statisticien, analist tregu/analist biznesi, ekonomist agrar, analist tregu, analist marketing, ekonomist i mjedisit dhe burimeve natyrore, në organizata të ndryshme publike dhe private, si edhe institucione të qeverisjes qendrore ose lokale.</p> <p>Programi i studimit është ndërtuar plotësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si edhe profilin përkatës.</p> <p>Plani mësimor përveç argumentave të mbështetura në analizën e kriterëve të standardit II.1, II.2 dhe II.3, shërben gjithashtu për të verifikuar mënyrën e organizimit të lëndëve të përgjithshme ndaj lëndëve specifike të profesionit. Siç konstatohet, lëndët e profesionit kryesisht realizohen në vitin e tretë të studimeve, së bashku me detyrimet përfundimtare, Diplomën ose provimin e Përgjithshëm Përfundimtar.</p> <p>Ndonëse raporti teori/praktikë në kuadrin e çdo lënde është në përputhje të plotë me profilin e programit, në kuadrin e përgjithshëm të studimeve, vlerësimi i praktikës në kohë dhe nëpërmjet krediteve, thekson natyrën praktike dhe efektive të njohurive të siguruar, duke rritur vlefshmërinë e diplomës së përfutur.</p> <p>GVJ konkludon se struktura e programit i përafrohet programeve të ngjashme ndërkombëtare, në shtesë të faktit që ky institucion është unik në vend.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017, pdf; 44. Analiza mësimore e FEAs, 2017-2018.pdf; 46. Analiza mësimore shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Objektivat formuese të programit, të specifikuar tek Rregullorja e Programit dhe Rregullorja e Departamentit, janë plotësisht të mbështetura nga struktura dhe organizimi i planit mësimor.</p> <p>Objektivat formuese të secilës lëndë janë të formuluar në mënyrë të qartë tek syllabuset përkatëse. GVJ gjykon që arritja e objektivave formuese në çdo lëndë është e mbështetur nga struktura e lëndës, në veçanti nga ndarja ndërmjet veprimtarive formuese si sipas lëndëve ashtu edhe sipas programit të përgjithshëm të studimeve akademike në Ekonomiks i Aplikuar, cikli i parë.</p>

	<i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Përmirësimi i përmbajtjes së lëndëve dhe moduleve është objekt i diskutimit në departament, bazuar në diskutimet me personelin e departamentit. Këtij qëllimi i shërben eksperiencë e fituar nga pjesëmarrja në programe kualifikimi jashtë vendit e disa pedagogëve si edhe këmbimi i eksperiencës me disa universitete të cilat aplikojnë programe të ngjashme.</p> <p>Programet e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Përditësimi përfshin literature bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi si edhe metoda më efektive e të përparuara të mësimdhënies.</p> <p>Ndryshimet në literature miratohen çdo vit akademik. Literatura e çdo lënde, si literature e detyrueshme, ashtu edhe ajo alternative, janë pjesë e syllabusit të lëndës.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	<p>Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive të larmishme mbi Ekonomiksin Bujqësor, të Burimeve natyrore dhe ambientit, Publik, i Punës, i Zhvillimit rural, Institucional, Menaxherial, Parave &amp; bankave, Ndërkombëtar dhe i Prodhimit Bujqësor.</p> <p>Njësia bazë konsideron nevojë parësore analizën e vazhdueshme të tregut, të cilën e ka realizuar dhe e ka përdorur për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies si edhe rritur efektivitetin e studimeve akademike, të konfirmuar nga pozicionimi në treg të studentëve dhe kariera e tyre.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Nisur nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Objektivat formuese të programit;</li> <li>▪ Harmonizimi i lëndëve bazë dhe karakterizuese me ato me zgjedhje dhe plotësuese;</li> <li>▪ Ndërthurja e njohurive teorike dhe praktike;</li> <li>▪ Përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës;</li> <li>▪ Përmirësimi i metodave të mësimdhënies;</li> <li>▪ Kriteret e pranimit dhe transferimit,</li> </ul> <p>GVJ mbështet përfundimin se program i studimit jo vetëm mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, por edhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës. Rritja e numrit të studentëve me rreth 50% në vitin akademik 2017-2018 në krahasim me 3</p>

	<p>vitet e mëparshme është treguesi më i qartë i rritjes së kërkesës për këtë program.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 33. Evidenca Sekretaria mësimore, 2019.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Njësia bazë i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të përmbajtjes së programeve të studimit, gjë e cila konstatohet nga dokumentacioni udhëzues i përgatitur nga institucioni, mbi kriteret dhe formatin e syllabuseve, si edhe materialet didaktike të nevojshme që duhet të përfshihen në mënyrë të detyrueshme në syllabus.</p> <p>Njësia bashkëpunon me partnerë nga tregu i punës, me të cilët organizohet çdo vit “Panairi i Karrierës”, i cili jo vetëm lehtëson kontaktet e studentëve me institucione, por rrit prezencën dhe përfshirjen e specialistëve në institucion, duke mundësuar ofrimin e informacionit të përditësuar dhe konkret mbi zhvillimin e politikave të zhvillimit rural dhe të agrobiznesit në vend.</p> <p>Njësia organizon leksione të hapura me të ftuar nga tregu i punës.</p> <p>Njësia bazë sikundër i gjithë UBT organizon programe kualifikimi, seminare dhe diskutime, me fokus “Marrëdhëniet me tregun e punës dhe mënyrat e nxitjes së karrierës të studentëve”.</p> <p><i>GVJ konstaton se evidencat të cilat të dëshmojnë efektivitetin e këtyre bashkëpunimeve si edhe të tregojnë shkallën e ndikimit të “eksperiencave dhe sugjerimeve të tregut të punës” në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, mungojnë.</i></p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 30. Lista e pedagogëve të ftuar, 2018.pdf; 57. Lista e materialeve didaktike të detyrueshme të përfshira në syllabuse.pdf; 72. Lista e leksioneve të hapura.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit, i përmbush kërkesat ligjore, të përcaktuara në Ligjin për arsimin e lartë, ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.</p> <p><i>[Referenca: 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 27. Elementë të programit të studimit.pdf; 28. Lista e stafit të njësisë kryesore.pdf]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p><a href="#">29. Lista e plotë emërore e personelit akademik të programit EA, 2018-2019;</a> <a href="#">31. Lista e CV-ve të pedagogëve të angazhuar.pdf</a></p> <p>Stafi akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore.</p> <p>45% e stafit akademik të angazhuar në këtë program është i kualifikimit më të lartë, Profesor dhe Profesor i Asociuar. 42% e stafit të angazhuar është me gradën Doktor dhe Docent, ndërsa vetëm 13% e stafit të angazhuar, ku bën pjesë edhe stafi me kohë të pjeshme është me gradën Msc. Konkretisht:</p> <p><b><u>Për vitin akademik 2019-2020:</u></b></p> <p>Personeli akademik i brendshëm i angazhuar në këtë program studimi (PAE) rezulton se është (34 gjithsej) me këtë kualifikim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 Prof.Dr</li> <li>- 11 Prof As</li> <li>- 14 Dr/PhD</li> <li>- 5 Msc</li> </ul> <p>Personeli akademik i jashtëm (PAK) rezulton se është (4 gjithsej)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2 Prof As</li> <li>- 2 Dr</li> </ul> <p>Raporti është 89.5% PAE dhe 10.5% PAK</p> <p><b><u>Për vitin akademik 2018-2019:</u></b></p> <p>Personeli akademik i brendshëm (PAE) rezulton se është (31 gjithsej) me këtë kualifikim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 Prof.Dr</li> <li>- 11 Prof As</li> <li>- 11 Dr/PhD</li> <li>- 5 Msc</li> </ul> <p>Personeli akademik i jashtëm (PAK) rezulton se është (5 gjithsej)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2. Prof As</li> <li>- 1. Dr/PhD</li> <li>- 2. Msc</li> </ul> <p>Raporti është 86% PAE dhe 14% PAK</p> <p><b><u>Për vitin akademik 2017-2018:</u></b></p> <p>Për këtë vit akademik nuk ka informacion të dedikuar lidhur me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit (PAE &amp; PAK). Nga informacioni i paraqitur në raportin vjetor të departamentit për këtë vit</p>
--	--



	<p>akademik GVI konstatoi se personeli akademik i brendshëm (PAE) i DEPZHR ishte (25 gjithsej) me këtë kualifikim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 4 Prof.Dr</li> <li>- 10 Prof As</li> <li>- 8 Dr/PhD</li> <li>- 3 Msc</li> </ul> <p>Njësia bazë merr të gjitha masat për të garantuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe shkencor të stafit, e cila realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga njësia.</li> <li>▪ Pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> <li>▪ Pjesëmarrjes në projekte</li> <li>▪ Shkëmbimeve akademike nëpërmjet projektit Erasmus.</li> </ul> <p>Vetëm në periudhën e fundit përpara izolimit për shkak të pandemisë, tre ekspertë të huaj kanë zhvilluar seminare për stafin akademik të njësisë.</p> <p>Çdo udhëtim apo pjesëmarrje sjell praktika të reja mësimdhënie, të cilat ju bëhen të njohura të gjithë anëtarëve të stafit nëpërmjet raporteve që plotësohen nga secili përfitues, pas kthimit nga aktiviteti. Këto praktika diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore.</p> <p>Diskutimet me stafin gjatë vizitës në institucion përforëcuan opinionin se mobiliteti i stafit është një mënyrë shumë e mirë për rritje dhe zhvillim.</p> <p>Duke marrë shkas nga situata tepër e vështirë dhe e veçantë e këtij viti e shkaktuar nga pandemia, gjatë vizitës u diskutua nëse stafi akademik u ndihmua me trajnime për të mundësuar njohjen dhe përvetësimin e teknologjive të reja, për realizimin e mësimin online. Rezulton se pandemia mundësoi njohjen me teknologji të reja, të cilat nëpërmjet ndihmës së zyrës së IT krijuan kushtet që mësimdhënia online të funksionojë mirë. Infrastruktura e përshtatshme e universitetit, e cila ka ndryshuar pozitivisht, sidomos krahasuar me rreth katër vite më parë, ka qenë një factor përcaktues për mbarëvajtjen e mësimin online si edhe relaizimin e aktiviteteve të tjera zhvilluese dhe kualifikuese.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 28.Lista e stafit të njësisë kryesore.pdf; 29. Lista e plotë emërore e personelit akademik të programit EA, 2018-2019; 30. Lista e pedagogëve të ftuar, 2018.pdf; 31. Lista e CV-ve të pedagogëve të angazhuar.pdf; 77. Lista e mobiliteteve të stafit, 2016-2018.pdf; 72. Lista e leksioneve të hapura.pdf; 73. Lista e leksioneve inovative.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në</p>	<p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij.</p>



<p>përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” për vitin akademik 2019-2020 realizohet nga 36 pedagogë PAE dhe 2 PAK, nga të cilët 18 pedagogë janë pjesë e Departamentit të Ekonomiës dhe Politikave të Zhvillimit Rural. Pedagogët e tjerë, përkatësisht nga pesë departamentet e tjera të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, mbulojnë disiplinat përkatëse, duke realizuar një përputhje të plotë të formimit të tyre me kërkesat e programit akademik.</p> <p><i>[Referenca: 28. Lista e stafit të njësisë kryesore.pdf; 29. Lista e plotë emërore e personelit akademik të programit EA, 2018-2019; 27. Elementë të programit të studimit.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë, në përputhje me planin e saj të kërkimit shkencor si edhe në bashkëpunim me institucione me të cilët ka një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe afatgjatë, përcakton fushat e studimit, për të cilat informohen studentët, që paraqisin kërkesat e tyre në lidhje me tematikën që do të studjojnë përgjatë përgatitjes së diplomës përfundimtare (vetëm studentët me note mesatare mbi 6.5). Departamenti finalizon ndarjen e temave në përputhje me përkatësinë shkencore të stafit akademik, sipas grupeve kërkimore të njësisë, por jo më shumë se 3 studentë për secilin pedagog. Nisur nga numri i lartë i bashkëpunimeve si edhe qëndrueshmëria e tyre, veçanërisht me institucione të rëndësishme të veçantë, si INSTAT dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, departamenti lehtëson bashkëpunimin e studentëve me institucionet për realizimin e punimit shkencor përfundimtar, përgatitjes së diplomës.</p> <p><i>[Referenca: 36. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit.pdf; Vizita në institucion; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë dhe institucioni përpiqen që të sigurojnë angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe aktiviteteve të tjera, pjesë e programit mësimor. Pjesë e stafit të Njësisë bazë është 1 sekretare departamenti, detyrat e së cilës janë të përcaktuara në nivel fakulteti dhe 1 Asistente pedagoge për 18 pedagogë, staf akademik. Njësia bazë është e paisur me mjete pune të nevojshme për realizimin e procesit akademik (fotokopje, kompjutera etj).</p> <p>GVJ gjykon që personeli ndihmës mësimor shkencor është i pamjaftueshëm për të garantuar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 28. Lista e stafit të njësisë kryesore.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse e programit të studimit në bashkëpunim me ZSCVI kujdeset për monitorimin e procesit mësimor dhe garantimin e mësimdhënies cilësore duke marrë veprime konkrete përmirësuese në nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Departamenti angazhon personelin akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit e cila i mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës.</p> <p>Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik, duke hartuar dhe një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e tyre. Zbatimi bëhet në nivel Rektorati, Dekani dhe Përgjegjësi i Njësisë sipas planit të masave të ngritura në nivel institucional.</p> <p>GVJ konstaton se stafi akademik vlerëson lirinë akademike, e cila konsiderohet parimi themelor i organizimit të procesit akademik në institucion, i sanksionuar edhe në Statut dhe Rregulloret përkatëse. Liria akademike i garanton stafit akademik mbështetjen ndaj iniciativave të tyre të aplikimit të metodave inovative në mësimdhënie.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 48. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.pdf; 73. Lista e leksioneve inovative.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (ZSCVI), e cila është pjesë e SKZHVI (Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional), e ngritur pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.</p> <p>ZSCVI në bashkëpunim me struktura përgjegjëse për zhvillimin e monitorimin e mësimdhënies programon kalendarin e procesit të vetëvlerësimit në nivel universiteti dhe ndjek realizimin e tij, si dhe bashkëpunon me Dekanët e fakulteteve për realizimin e vetëvlerësimit dhe ecurinë e veprimtarisë mësimore</p> <p>Si instrument për monitorimin e aftësive të mësimdhënies përdoret pyetëtori i studentëve, rezultatet e të cilit përpunohen nga ZSCVI.</p> <p>Institucioni ka përgatitur dhe përdor një kuadër të plotë rregullator dhe udhëheqës për garantimin e cilësisë. Pjesë e këtij kuadri janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ, 2017</li> <li>▪ Manuali I cilësisë,</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vendim KIZ për njësitë dhe individët e përfshirë SSBC</li> <li>▪ Pyetsori i studentit 2017-2018</li> <li>▪ Pyetsori online i studentit, 2019</li> <li>▪ Pyetsori i stafit akademik dhe ndihmës akademik.</li> </ul> <p>ZSCVI ka kompetencë të inspektojë raportet e vlerësimit të përgatitura nga njësitë dhe në rastet e evidentimit të problemeve apo pasaktësive, ose rastet e neglizhimit të standardeve të përshkruara në manualin për sigurimin e cilësisë në UBT, ka të drejtë të kërkojë korigjimin e tyre.</p> <p>Sipas procedurës për analizën dhe vlerësimin e cilësisë, miratuar në 2018, Nr.2844 Prot, ZSCVI analizon rezultatet e pyetësorit dhe harton raportin së bashku me rekomandimet përkatëse të cilat i vendos në dispozicion të njësive përgjegjëse. Njësitë diskutojnë rekomandimet në mbledhjen e Rektoratit, ku vendoset dhe mbi masat për përmirësimin e cilësisë. Plani i masave miratohet nga Senati Akademik dhe vendoset në dispozicion të njësive nga Rektori.</p> <p>GVJ u njoh me procedurën dhe përmbajtjen e pyetësorit gjatë vizitës në institucion, ku veç të tjerash, u shpjegua se si mekanizëm monitorimi shërben dhe dokumentimi periodik i performancës akademike të pedagogëve, i cili pasqyron ngarkesën mësimore, veprimtarinë akademike, performancën në kërkim shkencor dhe shërbimet ndaj të tretëve. Pra, bëhet normimi i procesit të mësimdhënies dhe i punës Kërkimore - Shkencore të njësisë përmes formularit të performancës. Kjo e fundit raportohet në raportin vjetor të Departamentit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 8. Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ, 2017.pdf; 9. Manuali I cilësisë.pdf; 34. Vendim KIZ për njësitë dhe individët e përfshirë në SSBC.pdf; 49. Pyetsori i studentit.pdf; 50. Pyetsori online i studentit, 2019.pdf; 51. Pyetsori i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf;]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në përputhje me Kriterin 2, UBT prej dy vitesh ndjek një proces rigoroz të vlerësimit të mësimdhënies përmes pyetësorit të studentëve. Anketimi hartohet nga ZSCVI dhe synon mbledhjen e opinionit të studentëve lidhur me procesin e mësimdhënies dhe çdo dukuri tjetër të lidhur me të.</p> <p>Ky proces zhvillohet dy herë në vit, në përfundim të semestrit dhe përpara sezonit të provimeve për të evituar ndikimin në vlerësim. Rezultatet janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore së bashku me formularin e performancës së stafit. GVJ në takimin me ZSCVI u njoh me përmbajtjen e pyetësorit dhe rezultatet e anketimit për vitin akademik 2018-2019, si dhe 2017-2018 të cilat janë publike në faqen zyrtare të UBT-së.</p> <p>Vizita në institucion, veçanërisht takimi me studentët konfirmoi se studentët janë pjesë e pyetësorit, dy herë në vit. Ndonëse rezultatet e pyetësorit nuk iu janë komunikuar studentëve, studentët pranojnë se komentet e tyre janë konsideruar.</p> <p>Studentët gjithashtu nënvizojnë se ndonëse koordinatori i studentëve si pozicion mungon, ata mund të kontaktojnë lirisht sekretaren e</p>

	<p>departamentit ose pedagogët, të cilët janë të disponueshëm, për rrjedhojë kanë akses në parashkrimin e problemeve apo kërkesave të tyre.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 49. Pyetsori i studentit.pdf; 50. Pyetsori online i studentit, 2019.pdf;]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>ZSCVI vë në dispozicion vlerësimet drejtuesve të institucionit, drejtuesve të njësisë si edhe në mënyrë të personalizuar secilit pedagog. Siç u pohua nga takimi me këtë zyrë, ato janë matësi kyesor i cilësisë së mësimdhënies në UBT. Rezultatet e tyre diskutohen në mbledhjet e departamentit dhe shoqërohen me marrjen e masave korrigjuese.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluar me ZSCVI dhe Përgjegjësen e Programit u pohua se rezultatet e gjeneruara nga vlerësimet bëhen publike në mbledhjet e departamentit dhe promovohen shembujt e praktikave më të mira, ndërsa merren masa për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë jo vetëm të mësimdhënies, por dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>Institucioni dhe njësia përgjegjëse është e angazhuar në rritjen e angazhimit kërkimor të stafit, ndonëse burimet financiare janë të kufizuara; si dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies përmes ofrimit të mundësive të mobilitetit për mësimdhënie përmes programit Erasmus + në Universitete Partnere si edhe projekteve të shumta në të cilat UBT është partner.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.2</b></p> <p><b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në programin e studimit “Ekonomiks i aplikuar” format kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Leksionet (870 orë totale në auditor)</li> <li>▪ Seminarët (870 orë totale në auditor)</li> <li>▪ Projekt/Detyra Kursi</li> <li>▪ Praktika profesionale</li> <li>▪ Orët e hapura</li> </ul> <p>Ndërsa tre të parat janë pjesë e vlerësimit të lëndës, dy të fundit shërbejnë për konsolidimin e njohurive teorike dhe nëpërmjet tyre, krijimin e shprehive praktike.</p> <p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies përbën prioritet për njësinë (departamentin), dhe është reflektuar jo vetëm në dokumentat zyrtarë si Plani Strategjik i UBT, 2016-2025, Analiza Mësimore FEAs, 2017-2018</p>

	<p>dhe Analiza kërkimore DEPZHR, 2018, por dhe në takimet e GVJ me përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit.</p> <p>GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Gjithashtu, pedagogët janë angazhuar për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimit, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale.</p> <p>Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimit të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gatishmërinë e pedagogëve për t'iu përgjigjur çdo pyetje e paqartësie të studentit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;2. 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017, pdf; 44. Analiza mësimore e FEAs, 2017-2018.pdf; 46. Analiza mësimore shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren mësimore, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, programet dhe syllabuset e lëndëve. Programi Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar” përfshin format e mësimit teorik e praktik si leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit. Mënyra kryesore e vlerësimit të dijeve është provimi final i modulit, ndërsa të tjera përfshijnë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimi i formimit ose mbrojtja e diplomës.</p> <p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se zhvillimi i orëve interaktive i lejon ata të përshihen më tepër dhe ndihmon mësimnxënien. Gjithashtu diskutimet dhe puna në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit nxisin të menduarit kritik.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>UBT trajnon pedagogët e jashtëm e të brendshëm mbi specifikat e rregullores, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Pjesë e rëndësishme e trajnimeve është përdorimi i sistemit të brendshëm të komunikimit me studentët, për sigurimin e materialeve teorike dhe vlerësimet e studentëve.</p> <p>Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në funksion të moduleve aplikative, UBT ka në dispozicion salla kompjuterike të pajisura me programe kompjuterike bashkëkohore, ku studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike.</p> <p>Departamenti angazhon personelin akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit e cila i mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës.</p>



	<p>Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik, duke hartuar dhe një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e tyre. Institucioni ka përgatitur “Listë të materialeve didaktike të detyrueshme për t’u përfshirë në syllabus”.</p> <p>Zbatimi i udhëzuesve bëhet në nivel Rektorati, Dekani dhe Përgjegjësi i Njesisë sipas planit të masave të ngritura në nivel institucional.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 48. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.pdf; 57. Lista e materialeve didaktike të detyrueshme të përfshira në syllabus.pdf; 73. Lista e leksioneve inovative.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i Njesisë bazë, përgjegjëse për programin Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”, përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Stafit akademik me gradën Profesor dhe Profesor i Asociuar përbën 45%, ndërsa ai me gradën Docent dhe Doktor përbën 42%.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të personelit akademik, u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar.</p> <p>Personeli akademik është i angazhuar në kërkim shkencor. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies. Rezultatet e punës kërkimore shkencore paraqiten në botime brenda dhe jashtë vendit. Secili anëtar I stafit realizon mesatarisht 3 botime në vit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se departamenti i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Departamenti mbledhet periodikisht për të evidentuar arritjet dhe problematika që duhen përmirësuar.</p> <p>Për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies shërbejnë anketimet e studentëve si edhe diskutimet, të cilat evidentojnë problematikat e mundshme lidhur me procesin mësimor. Sugjerimet nga ana e studentëve vlerësohen dhe reflektohen nga departamenti në përmirësim të mësimdhënies.</p> <p>Përmirësimi i metodës së mësimdhënies është objekt i analizës mësimore shkencore që realizohet çdo vit akademik.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 46. Analiza mësimore-shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; 48. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik dhe studentët, evidentoi se mësimdhënia është interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale dhe integrimi i literaturës ndërkombëtare krijon interes dhe përfshirje të studentëve në zgjidhje analitike të rasteve të huaja dhe</p>



	vendase. Materialet didaktike të përdorura përbëhen dhe nga materiale audivizuale të cilat krijojnë situata diskutimesh interaktive dhe nxisin punën në grupe të studentëve.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Metodat interaktive të mësimdhënies përqëndrohen tek mundësitë dhe interesat e studentëve. Personeli akademik i programit të studimit nxit studentët të ndërmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunim në zgjidhjen e problemeve në seminare etj.  Bashkëpunimi i ndërsjellë pedagog-studentë vihet re në auditor, në detyrat e ndryshme të kursit, në projekte e hartimin e diplomës si edhe në mbikqyrjen e praktikës mësimore, realizimi I të cilës mundësohet në sajë të kontakteve dhe bashkëpunimeve të UBT me institucionet publike dhe jo publike.  [Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b> <b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi mësimor i programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore, Godina A dhe Godina B. Godina A është e organizuar në 2 kate dhe ka në përbërje të saj 7 Salla leksionesh dhe 6 salla seminaresh, 4 laboratorë për zhvillimin e lëndëve të ndryshme si Informatikë, Statistikë, Ekonometri, Kontabilitet, etj. Godina B është e organizuar në 4 kate dhe ka në përbërje të saj 8 Salla leksionesh dhe 19 salla seminaresh, 2 laboratorë për zhvillimin e lëndëve të ndryshme si Informatikë, Statistikë, Ekonometri, Kontabilitet, etj. Të dy godinat mirëmbahen dhe pastrohen nga stafi ndihmës i fakultetit.  Gjithashtu studentët kanë në dispozicion bilbotekën e Fakultetit të Ekonomisë, bibliotekë e pasur në titujt bashkëkohor të literaturës të huaj e vendase.  Nga vizita në institucion u vu re se institucioni bën përpjekje për mirëmbajtjen e ambienteve dhe në ruajtjen e standardeve në ambientet e përbashkëta.  [Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;]
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për	Nga vizita e realizuar në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, GVJ konstatoi se mjediset ku zhvillohet mësimi plotësojnë kriteret e nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies cilësore. Në këto mjedise, u konstatua se sallat e leksioneve e seminareve, laboratorëve, sallat

<p>realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>e mbledhjeve, zyra e studio janë të përshtatshme për zhvillimin e këtij programi studimi.</p> <p>Ambientet janë të pajisura me kushtet optimale kryesisht në drejtim të paisjeve teknologjike, si kompjuter e video-projektor, tablo dhe dërrasë dixhitale të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sidoqoftë, mbështetur tek diskutimet me studentët është e nevojshme të investohet tek ngrohja, shërbimi i ushqimit nëpërmjet ndërtimit të një mense si edhe sigurimi i transportit të përshtatshëm publik.</p> <p>Ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas VKM nr 418, datë 10.05.2017, është 2.5 m<sup>2</sup> për student.</p> <p><i>GVJ rekomadon të përmirësohet logjistika e nevojshme IT për realizimin me cilësi të procesit mësimor. Gjithashtu GVJ sugjeron se duhet të investohet tek infrastruktura e shërbimeve për studentët si edhe e kushteve të përshtatshme të zhvillimit të procesit mësimor.</i></p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion].</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se të gjitha sallat e leksioneve në godinën B janë të pajisura me video projektor, ndërsa për sallat e godinës A, pranë sekretarive të departamenteve ka gjithmonë video projektorë të cilët mund të përdoren nga stafi.</p> <p>Godinat FEA-s janë të mbuluara me wireless si dhe kanë akses interneti në të gjitha sallat. Gjithashtu 6 laboratorë me kompjutera mund të përdoren nga studentët gjatë zhvillimit të orëve mësimore si edhe për përgatitjen e detyrave të kursit apo detyrime të tjera.</p> <p>Institucioni ka përgatitur dhe përdor “Manual për përdorimin e Google Apps”, për të unifikuar dhe lehtësuar përdorimin e sistemit IT në funksion të mësimdhënies.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 59. Manual për përdorimin e “Google APPS”.pdf; Dokumente plotësuese].</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve janë të ndërtuara sipas një formati të përcaktuar në rregullore si edhe në udhëzime përkatëse. Në këtë format, përcaktohet detyrimi për të përfshirë literaturën bazë e cila përditësohet çdo vit.</p> <p>Literatura bazë përfshin tekstin bazë si edhe literaturë ndihmëse për studentët. Njësia bazë vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet dy bibliotekave dhe librarisë universitare tekstet mësimore të përcaktuara në programet e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazën e planit të hartuar nga përgjegjësi i programit.</p> <p>Literatura bazë për çdo modul që ofrohet në këtë program studimesh është në gjuhën shqipe, vendin kryesor të së cilës e zënë botimet e stafit. Personeli akademik përdor çdo instrument dhe mundësi për të siguruar efektivitetin e mësimdhënies.</p> <p>Projektet e bashkëpunimit të FEAs me universitete të tjera jashtë vendit janë një burim i rëndësishëm i pasurimit dhe fuqizimit të bibliotekës.</p>

	<p>Salla e leximit është gjithashtu mjaft e përshtatshme dhe e preferuar për studentët, të cilët e shfrytëzojnë kryesisht gjatë sezonit të provimeve.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 57. Lista e materialeve didaktike të detyrueshme të përfshira në syllabuse.pdf.]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Bibliotekat e UBT, 3 kate, 1024 m<sup>2</sup>, 25000 tituj, mbi 200 poste janë tregues i cilësisë së infrastrukturës akademike të institucionit. Siç edhe u shpjegua tek Kriteri 4, të dy bibliotekat e UBT janë të pasura me tituj bashkëkohorë. Në shtesë të tyre, ofrojnë informacione online nga burimet elektronike (me abonim ose pa pagesë), të siguruara falë bashkëpunimeve nga projekte të ndryshme. Institucioni zotëron edhe librari elektronike (TEEAL) me akses në disa prej revistave më të mira.</p> <p>Vizita në institucion, veçanërisht tek biblioteka dhe takimi me stafin konfirmoi se fondi i bibliotekës, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me burimet e përditësuara të literaturës të moduleve, të përcaktuara tek syllabuset e lëndëve.</p> <p>GVJ gjykon që njësia bazë trajton me përparësi zhvillimin dhe pasurimin e bibliotekës, si një instrument tepër efektiv në mbështetje të cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu integrimi në platformën Cobiss ka mundësuar përdorimin e katalogut online të bibliotekës si edhe burimet alternative të informacionit, në sajë të integritit edhe në komunitetin ndërkombëtar SpringShare.</p> <p>Sidoqoftë mundësitë e kufizuara të studentëve për të shfrytëzuar literaturën në gjuhë të huaj, ndikojnë në shkallën relativisht të ulët të përdorimit të literaturës studimore.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 53. Kapacitetet e UBT.pdf; 54. Plani Strategjik i Bibliotekës shkencore “Mentor Përmeti”, 2015-2020; 55. Biblioteka informacion.pdf; 56. Lista e hyrjeve të reja bibliografike Mars 2019.pdf;]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Përveç vlerësimeve të formuluar tek Kriteri 4 dhe 5, vizita në institucion, veçanërisht tek biblioteka e FEAs evidentoi përpjekjet e instituconit për vendosjen e Bibliotekës Dixhitale të mundësuar nga RASH. Ky investim do të ndihmojë studentët që të aksesojnë literaturë ndihmëse dhe thellojnë njohuritë sidomos përgjatë përgatitjes të temës së diplomës. Sidoqoftë, njohja e thelluar e gjuhës së huaj, sidomos asaj angleze mbetet një kusht i nevojshëm dhe tejet thelbësor.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ka vënë në dispozicion të studentëve 6 laboratorë mësimor informatike të pajisur me programe bashkëkohore që u nevojiten për kryerjen e detyrave të kursit dhe diplomës. Në 3 nga 6 laboratorë, ka edhe programe më specifike si SPSS, EViews, Financa 5 etj. Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, GVJ konstatoi se laboratorët shfrytëzohen në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;]</i></p>

<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se Njësia bazë ka të gjitha aftësitë dhe kapacitetet që të përdorë platforma online, siç edhe e ka përdorur gajtë pandemisë. Takimi me studentët solli informacione të mjaftueshme konfirmuese për dobinë e përdorimit të platformës si edhe efektivitetin e saj.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;]</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Komunikimi i brendshëm realizohet përmes adresave të email-it të krijuara nga institucioni për stafin akademik, administrativ dhe studentët. Siç u përmend më sipër UBT ka gjithashtu sistemin e komunikimit ESSE3. Përmes tij, studentët mund të aksesojnë Syllabusin e Lëndëve, leksionet e lëndëve, materialet në funksion të realizimit të lëndës dhe detyrat dhe vlerësimet përkatëse. Sistemi ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues student apo pedagog. Studenti merr gjithë bazën didaktike për lëndën por nuk ndërvepron me kolegët e tjerë të kursit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;]</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon programi i studimit dhe departamenti.</p> <p>Njësia bazë, në përputhje me planin e saj të kërkimit shkencor si edhe në bashkëpunim me institucione me të cilët ka një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe afatgjatë, përcakton fushat e studimit, për të cilat informohen studentët, që paraqisin kërkesat e tyre në lidhje me tematikën që do të studjojnë përgjatë përgatitjes së diplomës përfundimtare (vetëm studentët me note mesatare mbi 6.5). Departamenti finalizon ndarjen e temave në përputhje me përkatësinë shkencore të stafit akademik, sipas grupeve kërkimore të njësisë, por jo më shumë se 3 studentë për secilin pedagog. Studentët informohen mbi pedagogun udhëheqës dhe procedurën si nëpërmjet shpalljes në ambientet e fakultetit ashtue dhe nëpërmjet faqes së web.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2018/2019, rreth 30% e studentëve kanë realizuar temë diplome në përfundim të studimeve akademike në Bsc “Ekonomiks i Aplikuar” (30 studentë), ndërsa në vitin akademik 2019-2020 janë 22 studentë.</p> <p>GVJ konstaton se njësia bazë mban dhe realizon përgjegjësi në procesin e realizimit të detyrimeve përmbyllëse të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 85. Lista e temave për diplomim.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në nivel universiteti janë organizuar struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sektori i Zhvillimit të Kurikulave dhe Vlerësimit Institucional i cili është nën drejtimin e zëvendësrektori për mësimin.</li> <li>▪ Zyra e Studimeve dhe Studentëve (pjesë e SZhKVI).</li> <li>▪ Zyra e mësimin dhe Kurikulave (pjesë e SKZhVI).</li> <li>▪ Zyra e Sigurimit të Cilësisë &amp; Vlerësimit Institucional (pjesë e SKZhVI).</li> </ul> <p>Veprimtaria e ZSCVI përfshin monitorimin e vazhdueshëm të institucionit në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndjekjen e vazhdueshme të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performances;</li> <li>▪ Ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij;</li> <li>▪ Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij;</li> <li>▪ Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion.</li> </ul> <p>Personi përgjegjës për cilësinë e mësimin në nivel njësie qendrore (FEA) është zëvendësdekani për mësimin dhe kurrikulat i cili emërohet nga dekani. Ai nën drejtimin e dekanit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Organizon, ndjek dhe kontrollon gjithë veprimtarinë mësimore në Fakultet.</li> <li>▪ Ndjek dhe përgjigjet për zbatimin e kurrikulave, planeve dhe programeve mësimore, strukturës së vitit akademik etj., për dy ciklet e studimeve (Bachelor, Master Shkencor dhe Master Profesional) në departamente.</li> <li>▪ Përgjigjet për organizimin, ndjekjen dhe zhvillimin e analizave të punës mësimore në departamente dhe ndjek procedurat e vetëvlerësimit në departamente.</li> <li>▪ Në bashkëpunim me përgjegjës të departamentit të sigurojë përmirësimin e cilësisë nëpërmjet pyetësorit të studentëve, nxjerrjes së të pikave të dobëta dhe paraqitjes së masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies si në nivelin e formës ashtu edhe atë të përmbajtjes.</li> </ul> <p>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin përkatës si edhe diskutoi me stafin përgjegjës gjatë vizitës në institucion, konstaton se Institucioni i ka realizuar me përgjegjësi detyrimet e tij në lidhje me organizimin e strukturave në nivel institucional për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinuar dhe bashkërenduar aktivitetin e përgjithshëm në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>
---	---



	<p>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;2. Statuti UBT, pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 8. Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ, 2017.pdf;]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e brendshme të FEAs, rezulton se veprimtaria e ndikjes dhe garantimit të cilësisë së mësimdhënies rregullohet dhe mbikqyret në nivel fakulteti.</p> <p>Dekani është institucioni përgjegjës për të gjithë procesin dhe punën mësimore e shkencore dhe garantimin e transferimit të dijeve në fakultet.</p> <p>Departamenti, DEPZHR si njësi bazë, ka për detyrë të nxisë, programojë, bashkërendojë, zhvillojë, organizojë dhe administrojë veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit ka përgjegjësinë e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të masave për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>Projektet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit, në veçanti projekti ERASMUS+, ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se Njësia kryesore dhe ajo bazë duke u mbështetur në legjislacionin rregullator të institucionit janë të afta të ushtrjnë funksionet e tyre nëpërmjet hartimit të planit të masave dhe kontrollin e vazhdueshëm të tyre me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, sipas kërkesave bashkëkohore.</p> <p>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion;2. Statuti UBT, pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 46. Analiza mësimore shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; 77. Lista e mobiliteteve të stafit, 2016-2018.pdf]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni dhe njësia bazë nxisin në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin e metodave të reja inovative, jo vetëm nëpërmjet zbulimit dhe përhapjes së praktikave të mira, por së pari, nëpërmjet hartimit të strategjisë dhe më tej, zbatimit të saj, me qëllim përgatitjen e terrenit të nevojshëm për zhvillimin e iniciativave inovative të mësimdhënies. Kjo strategji përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hartimin e udhëzuesve në nivel institucioni për përfshirjen e metodave inovative të mësimdhënies.</li> <li>▪ Organizimin e Seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga njësia.</li> <li>▪ Pjesëmarrje në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.</li> <li>▪ Pjesëmarrje në projekte</li> <li>▪ Shkëmbimeve akademike nëpërmjet projektit Erasmus.</li> <li>▪ Organizim leksione të hapura me pedagogë vendas dhe të huaj për shkëmbim eksperience në lidhje me metodat e mësimdhënies.</li> </ul> <p>Vetëm në periudhën e fundit përpara izolimit për shkak të pandemisë, tre ekspertë të huaj kanë zhvilluar seminare për stafin akademik të njësisë.</p>



	<p>Çdo udhëtim apo pjesëmarrje sjell praktika të reja mësimdhënie, të cilat ju bëhen të njohura të gjithë anëtarëve të stafit nëpërmjet raporteve që plotësohen nga secili përfitues, pas kthimit nga aktiviteti. Këto praktika diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore.</p> <p>Diskutimet me stafin gjatë vizitës në institucion përforëcuan opinionin se mobiliteti i stafit është një mënyrë shumë e mirë për rritje dhe zhvillim.</p> <p>GVJ vlerëson se institucioni përdor të gjithë instrumentat e mundshëm dhe zbulon mekanizma të rinj në funksion të përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. 30. Lista e pedagogëve të ftuar, 2018.pdf; 48. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.pdf; 57. Lista e materialeve didaktike të detyrueshme të përfshira në syllabuse.pdf; 77. Lista e mobiliteteve të stafit, 2016-2018.pdf; 72. Lista e leksioneve të hpura.pdf; 73. Lista e leksioneve inovative.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se pavarësisht kufizimeve financiare si edhe centralizimit të aktivitetit të përgjithshëm të institucionit, kualifikimi i stafit akademik është një nga prioritetet e UBT/FEA/DEPZHR.</p> <p>Njësia bazë për vitin akademik 2019-2020 përbëhet nga 18 pedagogë, nga të cilët, 3 profesorë, 8 profesorë të asociuar, 5 doktorë dhe 2 MSc. Staf i akademik i DEPZHR është i organizuar në katër GMK, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre, mësimdhëniedhe kërkim, në katër drejtime të rëndësishme; Ekonomiksit të Aplikuar, MikroMakroekonomi, Statistikë-Ekonometri dhe Politikave Bujqësore.</p> <p>Stafi i DEPZHR ka arritje të qënësishme, të reflektuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Numrin relativisht të lartë të botimeve të artikujve, mesatarisht 3 artikuj në vit për çdo pedagog.</li> <li>▪ Niveli i lartë revistave në të cilat kanë realizuar botimet.</li> <li>▪ Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare të organizuara brenda dhe jashtë vendit (ndonëse kjo nuk vlen për vitin e fundit, për shkak të pezullimeve të aktiviteteve në nivel global).</li> </ul> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. 28. Lista e stafit të njësisë kryesore.pdf; 29. Lista e plotë emërore e personelit akademik të programit EA, 2018-2019; 31. Lista e CV-ve të pedagogëve të angazhuar.pdf; 46. Analiza mësimore shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; 47. Analiza kërkimore DEPZHR, 2018.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin përkatës, veçanërisht analizat e aktivitetit mësimor dhe kërkimor në nivel departamenti si edhe pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin në projekte rajonale dhe ndërkombëtare, vlerëson se kualifikimi i vazhdueshëm i stafit trajtohet me përparësi.</p> <p>Vizita në institucion dhe diskutimi me personelin akademik tregoi se kualifikimi I stafit nëpërmjet trajnimeve ka përfshirë module të ndryshme</p>

	<p>si: rritja e aftësive për të hartuar projekte, për të përmirësuar metodat e mësimdhënies apo në lidhje me e-learning.</p> <p>Veçanërisht intrigues është pjesëmarrja dhe drejtimi nga DEPZHR i projektit SMARTAL, një projekt shumë dimensional, objektivat e të cilit janë përqëndruar jo vetëm tek rritja e kapaciteteve akademike por edhe ndërtimin e rrjeteve të bashkëpunimit shkencor dhe kërkimit ndërmjet vendeve të rajonit, BE-së dhe të Shqipërisë,</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 46. Analiza mësimore shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; 47. Analiza kërkimore DEPZHR, 2018.pdf; 74. Lista e projekteve, UBT, 2017-2018.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Shqyrtimi i kontratës së punës si edhe diskutimi me stafin akademik, udhëhoqën GVJ drejt konstatimit se Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit në mënyrë cilësore dhe të përgjegjshëm për të zbatuar detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, rregullorja e brendshme e institucionit sie dhe kodi i punës.</p> <p>Në përputhje me programin akademik, në fillim të çdo semestri, pedagogu harton planin kalendar që firmoset nga ai dhe përgjegjësi i departamentit, për realizimin e të cilit pedagogu është plotësisht përgjegjës.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 17. Model kontrate pune, personel akademik.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në shtesë të argumentave të paraqitura përgjatë analizës së evidencave dhe të dhënave që konfirmojnë përpjekjet dhe investimin e personelit akademik dhe drejtues në lidhje me nxitjen e metodave të reja innovative, GVJ diskutoi gjerësisht me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion, çështjen e eksperiencës së mësimin online gjatë semestrit të dytë 2019-2020, për shkak të pandemisë. GVJ vlerëson se si stafi dhe studentët e konsiderojnë këtë eksperiencë jashtëzakonisht të dobishme, ndërsa mësimdhënien e realizuar online, efektive, një metodë e cila edhe pas përfundimit të pandemisë mund të përdoret për të organizuar aktivitete kombëtare apo ndërkombëtare të cilat do të rrisin pjesëmarrjen e stafit dhe të studentëve duke reduktuar kostot.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Analiza paraprakisht e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe njësisë qartësisht tregoi se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse.</p> <p>Vizita në instucion, veçanërisht diskutimi me studentët konfirmoi vlerësimin se të gjitha kriteret dhe rregullat e mënyrat e testimit janë të njohura në sajë të publikimit në faqen e institucionit, në syllabusin e lëndës si edhe informimit e sqarimit nëpërmjet strukturave të institucionit.</p> <p>GVJ konstaton se mënyra kryesore e vlerësimit të dijeve është provimi final i modulit (lëndës), ndërsa të tjera përfshijnë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimi i formimit ose mbrojtja e diplomës.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në vijim të informacionit të dhënë tek kriteri 1 i këtij standardi, GVJ vlerëson se pedagogët i informojnë studentët në orën e parë të mësimit me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën që do të përdoret në modulën përkatës.</p> <p>Gjithashtu progarmet e lëndëve, përfshirë edhe elementët e mësipërm janë pjesë e publikimit të secilit pedagog, në faqet personale.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstatoi se Rregulloret e studimeve në UBT, FEA dhe njësinë bazë përcaktojnë qartë se format e kontrollit të dijeve janë komplekse dhe të larmishme, përkatësisht nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Testimi i ndërmjetëm.</li> <li>▪ Detyrat e kontrollit (detyra kursi ose projekte).</li> <li>▪ Provimi final.</li> </ul> <p>Studentët njihen qysh në fillim të semestrit me mënyrën e kontrollit të dijes dhe formën e organizimit të saj, në secilin modul.</p> <p>Sistemi i pikëzimit dhe i vlerësimit mbi bazën e pikëzimit është gjithashtu i standardizuar dhe i përcaktuar.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Dokumentacioni rregullator si edhe syllabuset e çdo lënde përcaktojnë qartë mënyrën e vlerësimit të studentit, e cila pavarësisht instrumentave standarde, përfshin vlerësimin e studentit në mënyrë të vazhduar, i llogaritur nga 25 deri 50% i vlerësimit të përgjithshëm.</p> <p>Është kompetencë e pedagogut që të përcaktojë raportin ndërmjet vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar, si edhe të informojë studentët, të cilët duhet të njohin jo vetëm mënyrën por edhe nivelin e përgjithshëm të pikëve paraprahe, përpara se sa të përfundojë kursi përkatës. Vizita në institucion tregoi se nuk ekzistojnë paqartësi apo konflikte për këtë çështje.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni është në faze finalizimi të projektit për instalimin e platformës digjitale dhe barkodeve për sekretimin dhe leximin elektronikë të testeve, në sajë të mbështetjes financiare të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se metodologjia e vlerësimit me “Clean score”, sistemi për vlerësimin kompjuterik të provimeve, sapo është futur. Në bazë të këtij sistemi, 7 lëndë do të korigjoheshin në mënyrë të pjesshme, ndërsa 1 lëndë do të korigjohesh plotësisht.</p> <p>Ky sistem do të testohet këtë semester, por për shkak të ndryshimeve që u aplikuan gjatë semestrit të dytë të vitit 2019-2020, të shkaktuara nga pandemia, tashmë rezultatet do të shihen vitin e ardhshëm akademik.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rregullorja e DEPZHR e përcakton qartë se Përgjegjësi i departamentit në cilësinë e koordinatorit të programit është përgjegjës për krijimi e komisioneve të provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit ndërsa antari tjetër është pjesëtar i GMK nga cili buron moduli, ndonëse për arsye praktike, procesi i provimit mund të asistohet edhe nga pedagogë të tjerë. Sidoqoftë, finalizimi I vendimit është kompetencë e dekanit të FEA.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf;]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Ende nuk është e aplikueshme. Në proces finalizimi.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion;]</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Ndonëse komentimi dhe argumentimi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve, është detyrim i përcaktuar në aktet rregullatore të institucionit, GVJ hulumtoi përgjatë vizitës në institucion, nisur nga rëndësia e problemit si edhe nga fakti i zhvillimit të vlerësimeve në mënyrë tradicionale, gjë që i lë hapësirë subjektivitetit.</p> <p>Studentët gjithashtu gëzojnë të drejtën e ankimimit, pasi njihen me rezultatet e provimeve nëpërmjet shpalljes në sistemin ESSE3.</p> <p>Vizita në institucion ndihmoi GVJ të konkludojë se pedagogët e ushtrojnë kompetencën e tyre të vlerësimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme. <i>Sidoqoftë, nevoja e dixhitalizimit të vlerësimit mbetet një koment i vlefshëm.</i></p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf;]</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Ndonëse vlerësimi për kriterin 6 është pjesërisht i paaplikueshëm për shkaqe të sqaruara tek vlerësimi i kriterit 5 dhe 4, njësia përgjegjëse dhe personeli akademik përpunon që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën.</p> <p>Së pari, personeli i ngarkuar me mbikqyrjen e provimit zbaton tërësisht rregulloren. Së dyti, komisioni i ngarkuar për vlerësimin jo vetëm zbaton rregulloren por ndërmerr edhe masa ndëshkimore në rast të shkeljes së saj.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf;]</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Mbështetur në rregulloret përkatëse, përgjegjësi i departamentit kontrollon dhe miraton tezën, mbi bazën e të cilës kontrollohen dhe vlerësohen njohuritë dhe dijet e prëftuara. Teza duhet të përfshijë të gjitha informacionet thelbësore të diskutuara në klasë gjatë zhvillimit të modulit.</p> <p>Gjithashtu, veprimet dhe detyrimet pas përfundimit të provimit dhe kontrollit të tij, janë të përcaktuara në rregullore. Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë.</p> <p>Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit.</p> <p>GVJ gjykon që institucioni përdor të gjitha instrumentat efektivë që të garantojë rezultate të bazuara mbi meritokracinë.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf;]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se jo vetëm nëpërmjet rregulloreve, por edhe si veprimtari praktike, e drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe ankimuar atë në rast se ankimimi është i nevojshëm, është e garantuar dhe ushtrohet, brenda dy ditëve (48 orë). Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem brenda dy ditëve.</p>



	<p>Procedura e përgjithshme pas korigjimit dhe shpalljes së provimit përfshin një kohëzgjatje 12 ditore, pas të cilës, sistemi nuk gjeneron më procesverbalin për atë modul.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf;]</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Pavarësisht të drejtës së studentit për ankimim, të parashkruar në statut dhe rregulloret përkatëse, institucioni nën kompetencën e Dekanit, realizon me përgjegjësi rastet e ankimeve, duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shqyrtuar ankesën.</li> <li>▪ Kërkimin e sqarimeve nga përgjegjësi I departamentit, komisioni I provimit dhe vetë student.</li> <li>▪ Përcaktimin nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo.</li> <li>▪ Marrjen e vendimit përkatës, i cili është i formës së prerë.</li> </ul> <p>Vizita në institucion tregoi se ka patur edhe raste gjatë analizës të të cilave, rezultati I provimit është shpallur i pavlefshëm. Në këtë rast, studentit i është garantuar rihënja e provimit me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. E gjithë procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë janë regjistruar në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë dhe të pjesshme, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra). Lidhur me përmbajtjen e programit të studimit, përbëhet nga (5) lëndë bazë, (17) lëndë të formimit karakterizues (6) lëndë ndërdisiplinore dhe me zgjedhje, përkatësisht nga 3 tek secila, (3) lëndë plotësuese, përfshirë edhe praktikën mësimore dhe Diploma.</p> <p>Programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për profilin e programit, për të ndjekur ciklet e tjera të thelluara të studimit si edhe për të ndërtuar karrierë të qëndrueshme në</p>



	<p>tregun epunës në disa specilitet të vlefshme në organizata publike dhe jo publike si edhe vendimmarrëse në nivel qendror ose vendor.</p> <p>GVJ konsideron të përshtatshme dhe efektive strukturën e programit si në raport me kërkesat bashkëkohore akademike ashtu edhe në raport me kërkesat e tregut lokal, rajonal apo ndërkombëtar të punës.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 18. Dosja e plotë e hapjes së programit të studimit.pdf; 18.1. vendim i Këshillit të Fakultetit për ndryshimin e emrit të departamentit.pdf; 19. Vendim i FEAs për çeljen e profilit Ekonomiks i Aplikuar, 23.11.2012.pdf; 20. Vendim i Rektoratit dhe i Senatit për hapjen e profilit Ekonomiks i Aplikuar.pdf; 21. Urdhër i Ministrisë për hapjen e programit, 31.05.2013.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Plani Mësimor siguron informacion të mjaftueshëm për të konfirmuar se programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në teknologji (lënda Informatikë), shkencë humane dhe shoqërore (Sociologji, Bazat e të Drejtës) si edhe aftësi për jetën nëpërmjet lëndëve ndërdisiplinore.</p> <p>Veçanërisht me vlerë është organizimi dhe realizimi i praktikës mësimore prej 12 javë në institucione, organizata dhe ndërmarrje publike dhe jo publike.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 27. Elementët e programit të studimit.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit paraqiten në syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave të rezultateve të pyetësorit të studentëve, diskutimeve me studentët dhe vlerësimeve përfundimtare të lëndës të cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mëtijshme në përputhje me qëllimet e programit të studimit. Tregues statistikorë të mbëdhur nga institucioni, që reflektojnë ecurinë e studentëve, gjithashtu konsiderohen për të argumentuar efektivitetin e programit të studimit.</p> <p>Dekani i fakultetit aktivizon komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregullores së tyre, i cili është përgjegjës për këtë proces.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 27. Elementët të programit të studimit, pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017, pdf; 46. Analiza mësimore shkencore DEPZHR, 2017-2018.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të çdo moduli dhe semestri, pedagogët realizojnë një seancë konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe</p>

	<p>udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.</p> <p><i>[Referenca: 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se njësia bazë bën përpjekje intensive që të ofrojë të reja më të përditësuara të shkencës dhe teknologjisë si nëpërmjet leksioneve të hapura ashtu edhe organizimit të seminareve. Në vijim të traditës së UBT, edhe gjatë periudhës Nëntor 2019 deri Mars 2020, pavarësisht vështirësive, janë realizuar 6 nga 8 leksione të hapura dhe 3 nga 4 seminare të planifikuara, me pjesëmarrje të ekspertëve të njohur të vendit dhe të huaj. Në këto aktivitete gama e çështjeve të trajtuara paraqitet e larmishme, duke mbuluar si metodat kërkimore, politikat e zhvillimit ashtu edhe vlerësimin e zbatimit të politikave të agrobiznesit dhe zhvillimit rural.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 72. Lista e leksioneve të hapura.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale.</p>	<p>GVJ konsideron përparësi evidente dhe të fuqishme ndryshimin e kohëzgjatjes së praktikës mësimore nga 6 në 12 javë si edhe realizimin e saj në institucione, aktiviteti i të cilave është pjesë e çështjeve të ekonomisë dhe agrobiznesit.</p> <p>Vizita në institucion, veçanërisht diskutimi me studentët, konfirmoi vlerësimin e GVJ, mbështetur në përshtypjet dhe deklaratimet mjaft positive të studentëve.</p> <p><i>[Referenca: Vizita në institucion; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 70. Programi i praktikës.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Një nga mënyrat e vlerësimit të studentëve realizohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe mbikqyrjes së përgatitjes të një detyre kursi ose projekti, të vlerësuar me 25 deri 50% të vlerësimit përfundimtar, në varësi nga specifikat e modulit si edhe vendimi i pedagogut përkatës.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Ky aktivitet i jep mundësi studentëve të punojnë në grup. Detyra e kursi në secilin prej moduleve ku ajo zhvillohet synon që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të krijojë mundësinë që studentët të analizojnë një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo me të dhëna të grumbulluara gjatë punës në grup;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të zhvillojë një mini projekt kërkimi në mënyrë individuale apo në grup;</li> <li>▪ Të zbatojë në praktikë dijet dhe instrumentet e fituara në modulet teorike;</li> <li>▪ Të familiarizohet me shprehjet e punës në grup;</li> <li>▪ Të analizojë në mënyrë të pavarur të dhëna dhe evidence dhe të ofrojë rekomandime.</li> </ul>

	<p>Detyrat e kursit shërbejnë si një bazë praktike shumë e rëndësishme për punën e temës së diplomës.</p> <p>Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët sipas grupeve të punës në lidhje me realizimin e detyrës së caktuar dhe stimulon zgjidhjen e një problemi biznesi.</p> <p>Në këtë proces personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat të cilat kanë nevojë për thellim teorik dhe studim të mëtejshëm. Njësia e ka pjesë të strategjisë kërkimore përfshirjen e studentëve në kërkime shkencore, process në të cilin mbështeten edhe nga program i këmbimeve akademike dhe kulturore, Erasmus, ndonëse numri i studentëve që aplikojnë nuk është shumë i lartë.</p> <p>Bazuar në RVB, rezulton se UBT në kuadër të marrëveshjes me Agjensinë e Planifikimit të Territorit UBT prej gushtit 2018 është pjesë e Akdaemise së 100 fshatrave, e cila ka mbështetur realizimin e aktiviteteve mësimore kërkimore në fushën e zhvillimit rural dhe turizmit, ku student e pedagogë kanë punuar në grupe pune. Rezultatet e arritura janë reflektuar në diploma dhe detyra kursi. Në mënyrë të vazhdueshme Universiteti Bujqësor i Tiranës, dhe FEA kanë organizuar konferenca shkencore të studentëve 210. Në konferencën e 6-të të organizuar në vitin 2017 u paraqitën 41 punime të cilët përfshinin më shumë se 100 studentë.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 27. Elementë të programit të studimit, pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion diskutoi gjerësisht në lidhje me mundësitë e studentëve për të aplikuar dhe marrë pjesë në programin Erasmus+. Ndonëse informacionet dëshmojnë se gjatë viteve të fundit janë rritur ndjeshëm mobilitetet e studentëve me universitetet e tjera homologe jashtë vendit sepse FEA është pjesë e një grupi projektsh Erasmus + Mobility që kanë si qëllim që të përmirësojnë dhe të përafrojnë praktikat e mësimdhënies së Pedagogëve të FEA me IAL partnere në Ballkan dhe Evropë, GVJ nuk mundi të aksesojë evidencat përkatëse statistikore, ndërsa studentët, me përjashtime të rralla, nuk ndjeheshin entuziastë në lidhje me eksperiencën Erasmus, shpesh here të kushtëzuara nga rrethana të tjera si për shembull pamundësia për të ndërprerë punën, arsye familjare ose vështirësi në gjuhën e huaj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.8</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, përshkruhet zhvillimi i procesit të diplomimit të studentëve të programit Bachelor në Ekonomiks i Aplikuar. Për t'u diplomuar studenti duhet t'i nënshtrohet një provimi të përgjithshëm formimi, ose të mbrojë një punim diplome, i cili të lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit dhe është një punim i pavarur shkencor i studentit. Kriteri themelor për formën e diplomimit është nota mesatare. Studentët me mesatare mbi 6.5 kanë të drejtë të mbrojnë diplomën me provim. Nota mesatare relativisht e ulët është vendosur në përputhje me interes e studentëve për të përgatitur temë diplome, në vend të provimit.</p> <p>Tematikat e punimeve shkencore për diploma shpallen kohë më parë, në përputhje me akset dhe fushat kërkimore, ndërsa studentët zgjedhin ndërmjet tyre në përputhje me interes e specializimit të tyre të mëtejshëm.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; <a href="http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/dep-i-ekonomise-dhe-politikave-te-zhvillimit-rural/departamenti-ekonomi-politika-te-zhvillimit-rural/">http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/dep-i-ekonomise-dhe-politikave-te-zhvillimit-rural/</a>; 85. Lista e temave për diplomim.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti. Gjithashtu udhëzon studentët me seanca metodologjike dhe sipas një kalendari takimesh duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme. Udhëheqësi i punimit të diplomës planifikon një kalendar komunikimi me studentin dhe përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet kohore të realizimit të tij. Një pedagog udhëheq 3 deri 5 studentë.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 85. Lista e temave për diplomim.pdf; <a href="http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/dep-i-ekonomise-dhe-politikave-te-zhvillimit-rural/departamenti-ekonomi-politika-te-zhvillimit-rural/">http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/dep-i-ekonomise-dhe-politikave-te-zhvillimit-rural/</a>; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf].</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në vend të punimit të diplomës, studenti ka të drejtë të zhvillojë një provim të përgjithshëm formimi, ku atij do ti duhet të aplikojë njohuritë kryesore të përfituara gjatë tre viteve të studimit për t'i dhënë përgjigje pyetjeve. Kjo procedurë është si dhe mbrojtja e diplomës përcaktohet në rregulloren e programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”.</p> <p>Teza e Provimit përfundimtar synon të vlerësojë njohuri përgjithësuese sipas programit, kryesisht të lëndëve me peshë specifike më të konsiderueshme. Studentët njihen me programin. Studentët orientohen dhe ndihmohen që të përgatiten për provimin përfundimtar.</p> <p>Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit,</p>

	<p>si dhe Dekani i Fakultetit. Programi shpallet, në websitin e FEA_s, dhe u bëhet i ditur studentëve të programit të studimit.</p> <p>Për vlerësimin e temave të diplomave, komisionet e vlerësimit konsiderojnë: punimin e paraqitur në formë të shkruar e të lidhur; prezantimin e punimit për diplomë nga ana e studentit gjatë mbrojtjes në komision; përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve të komisionit.</p> <p>Temat e diplomës dhe provimet e formimit vlerësohen nga i njëjti komision vlerësimi. Komisionet e vlerësimit përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë, propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit.</p> <p>GVJ gjykon që procedura e ndjekur për paraqitjen dhe mbrojtjen e detyrimeve përmbyllëse është përshkruar qartë në rregulloret përkatëse, ndërsa njësia realizon detyrimet e saj për të informuar, ndihmuar, koordinuar dhe udhëhequr studentët drejt plotësimit të tyre.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Jo vetëm shqyrtimi i dokumentacionit, por edhe vizita në institucion konfirmuan gadishmërinë dhe vullnetin e stafit akademik gjatë periudhës së sezonit të provimit përfundimtar/temës së diplomës për të sqaruar çdo pyetje dhe zgjidhur çdo shqetësim të studentëve.</p> <p>Pranë sekretarisë së departamentit nga ana e stafit dorëzohet axhenda javore e cila tregon edhe oraret se kur stafi akademik është në zyrë dhe mund të pres studentët.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Ashtu si edhe në vlerësimin e kriterit 4, GVJ konstaton se njësia bazë është e motivuar që të lehtësojë studentët, të cilët kanë të drejtë të përdorin laboratorët e UBT/FEA për të kryer analiza dhe përpunime të dhënash.</p> <p>Stafi akademik si dhe ndihmës akademik i ofron mbështetjen si dhe i konsultojnë për metodologjitë e përpunimit të të dhënave. Gjithshtu UBT zotëron edhe Fermën Didaktike Eksperimentale (FDE) ku studentët mund të zhvillojnë studime. Pranë kësaj Ferme ka një staf me eksperiencë dhe të gatshëm për të ndihmuar dhe asistuar.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ konfirmon se procedura e përcakton qartë që temat e diplomës udhëhiqen nga punonjësit mësimor-shkencor të Fakultetit që kanë titull apo gradë shkencore (ose së paku kualifikimin Master), ose nga punonjësit shkencorë të instituteve kërkimore që i përshtaten studimeve në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe që kanë kualifikim të lartë, si dhe nga shkencëtarë të huaj të fushës përkatëse të diplomimit.</p> <p>Puna përgatitore për realizimin e punimit shkencor të diplomës është rezultante e veprimtarisë së përbashkët ndërmjet udhëheqësit të punimit të diplomës, i cili përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij, si edhe e studentit, që duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës.</p>



	<i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; Dokumente plotësuese për akreditimin e programit të studimit EA 2019-2020.pdf]</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Rregullorja e brendshme e programit përcakton qartë mënyrën e vlerësimit të studentit pas përfundimit të detyrimeve përmblyëse. Komisioni i provimit, pas mbrojtjes, tërhiqet për të bërë vlerësimin përfundimtar.			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Nota përfundimtare si në rastin e mbrojtjes me punim, si në rastin e mbrojtjes me provim përfundimtar, llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit dhe i bëhet e ditur studentit ditën e mbrojtjes përpara komisionit. Por, në qoftë se tre nga anëtarët e komisionit japin vlerësime negative, atëherë provimi i formimit vlerësohet negativisht.  Për studentët që japin provim formimi, studentëve u jepet teza e provimit; Tezat e provimit përgatiten nga departamentet dhe miratohen nga dekani i Fakultetit. Koha e nevojshme për përgatitjen e studentit është 60 minuta.  Sipas Rregullores së Programit studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit.			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti i programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, listën e notave dhe sipas kërkesës nga një kopje të syllabuseve për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentëve ruhet nga UBT për një periudhë të pacaktuar që nga koha e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve.  Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretaries mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim.  <i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; Vizita në institucion; 2. Statuti UBT, pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e studimeve për programin EA, 2017.pdf; 22. Modeli i diplomës Ekonomiks i Aplikuar, Urdhër i aprovimit.pdf; 23. Suplementi i diplomës.pdf]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të përditësuara për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar”.</p> <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Pagave, strukturë në varësi të Rektorit të UBT, është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave për personelin në formatin e dosjeve personale.</p> <p>Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale, GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT 2017.pdf; 11. Rregullore Burimeve Njerëzore, 2018.pdf; 13. Format i dosjes personale.pdf; 17. Model kontrate pune; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, faqen web të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UBT.</p> <p>Në faqen zyrtare web të UBT dhe në regjistrin e APP publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit për çdo vend pune, të cilat janë në përputhje me specifikat e programit të studimit.</p> <p><i>[Referenca: 2. Statuti UBT 2017.pdf; 11. Rregullore e Rekrutimit, 2018.pdf; 14. Format i publikimit të ofertës për vend pune të lirë.pdf; 15. Format i publikimit të kriterëve.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret e përgjithshme të rekrutimit përcaktohen nga Senati i UBT, ndërsa kriteret specifike të rekrutimit përcaktohen nga njësi bazë dhe miratohen nga Rektori i UBT.</p> <p>Rregullorja e rekrutimit përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit ad hoc që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Në rastin e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, Drejtuesi i Njësisë Bazë që mbulon programin e studimit për të cilin synohet rekrutimi, është pjesë e komisionit ad hoc të vlerësimit. Në çdo rast, i gjithë procesi i rekrutimit ndiqet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore &amp; Pagave.</p> <p><i>[Referenca: 2. Statuti UBT 2017.pdf; 11. Rregullore e Rekrutimit, 2018.pdf; 16. Format i finalizimit të procedurës së konkurimit.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret e përgjithshme të rekrutimit përcaktohen nga Senati i UBT, ndërsa kriteret specifike të rekrutimit përcaktohen nga njësi bazë dhe miratohen nga Rektori i UBT.</p> <p>Rregullorja e rekrutimit përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit ad hoc që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Në rastin e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, Drejtuesi i Njësisë Bazë që mbulon programin e studimit për të cilin synohet rekrutimi, është pjesë e komisionit ad hoc të vlerësimit. Në çdo rast, i gjithë procesi i rekrutimit ndiqet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore &amp; Pagave.</p> <p><i>[Referenca: 2. Statuti UBT 2017.pdf; 11. Rregullore e Rekrutimit, 2018.pdf; 16. Format i finalizimit të procedurës së konkurimit.pdf; vizita në institucion]</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efektive dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”.</p> <p>Mjediset në të cilat zhvillohen aktivitetet mësimore, kërkimore dhe administrative, të këtij programi studimi janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 53. Kapacitetet e UBT; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” administrohet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural (DEPZHR), i Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) të UBT. Me synimin e një organizimi sa më efikas dhe sa më eficient të mësimdhënies dhe punës kërkimore, stafi akademik i këtij departamenti është i organizuar në katër grupe mësimore kërkimore (GMK):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ GMK i Statistikës dhe Ekonometrisë;</li> <li>▪ GMK i Politikave Bujqësore;</li> <li>▪ GMK i Mikro dhe Makroekonomisë; si dhe</li> <li>▪ GMK i Ekonomiksit të Aplikuar.</li> </ul> <p>Në takimin me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi angazhimin dhe mbështetjen e UBT për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik nëpërmjet përfshirjes në marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me institucione partnere ndërkombëtare dhe kombëtare në nivel kërkimi, mësimdhënieje dhe projektsh të ngjashme.</p> <p>Vëmendja e UBT për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit shprehet qartë edhe në prioritetet e vendosura në planin strategjik të zhvillimit të institucionit bazuar në analizën SWOT.</p>

	[Referenca: 3. Plani Strategjik i UBT-së 2016-2025; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 6. Rregullore e brendshme e DEPZHR, 2017.pdf; 82. Emërimi i Përgjegjësve të GMK ve të FEA-s.pdf; vizita në institucion]			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB si dhe informacionit të marrë në takimin me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi se personeli i angazhuar në këtë program studimi në kuadrin e projekteve të ndryshme të bashkëpunimit me universitete partnere, ka përfituar mobilitete me synim mësimdhënien të cilat kanë mundësuar kualifikime edhe për metodat inovative të mësimdhënies, përdorimin e teknologjive të reja si edhe integrimin në rrjete kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Gjithashtu, gjatë këtij takimi GVJ konstatoi se institucioni mbështet dhe nxit bashkëpunimin mes personelit akademik të ri dhe atij me eksperiencë në procesin mësimor dhe kërkimor, si dhe angazhimin në projekte ndërkombëtare.</p> <p>Në nivel institucioni janë krijuar udhëzues dhe manuale për të lehtësuar transferimin e përvojës pozitive të krijuar lidhur me përdorimin e metodave dhe teknologjive të reja në mësimdhënie.</p> <p>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 48. Udhëzues në nivel institucional për zbatimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.pdf; 59. Manual per përdorimin e "GOOGLE APPS".pdf; vizita në institucion]</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se aktualisht stafi akademik me kohë të plotë i Departamentit të Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural (DEPZHR), mbulon mesatarisht 1-2 lëndë në këtë program studimi dhe me një ngarkesë totale orare (në të gjitha programet dhe nivelet e studimit) që varion nga 1.5 deri në 3 herë ngarkesën bazë të përcaktuar nga VKM përkatëse.</p> <p>Në takimin gjatë vizitës në institucion, stafi akademik dëshmoi se ngarkesa aktuale ishte mëse e përballueshme dhe nuk cënonte realizimin cilësor të objektivave të programit të studimit dhe të personelit akademik të angazhuar.</p> <p>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 6. Rregullore e brendshme e DEPZHR, 2017.pdf; 27. Elementët e Programit të Studimit.pdf; 29. Lista e plotë emërore e personelit akademik të Programit EA, 2018-2019.pdf; 80. Urdhër i pagesave të mbingarkesave 27.07.2018.pdf; vizita në institucion]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

#### Kriteret

**Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

#### Vlerësimi i ekspertëve

Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe gjatë vizitës në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), GVJ konstatoi se institucioni ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.

Të dhënat për mjediset në dispozicion të studentëve dhe personelit pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) paraqiten si vijon:

Mjedisi - FEA	Nr. Sallash
Salla leksioni	15
Salla seminari	25
Laborator informatike	6
Bibliotekë	1
Ambiente ndihmëse	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Librari/fotokopje</li><li>▪ Zyrë informacioni</li><li>▪ Zyra e karrierës</li></ul>

Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zhvillohej gjatë ditëve të javës, në të dy godinat e FEA, në intervalin orar 8.30-14.30.

[Referenca: [RVB\\_Bachelor\\_Ekonomiks\\_i\\_Aplikuar.pdf](#); 2. [Statuti UBT 2017.pdf](#); 5. [Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf](#); 53. [Kapacitetet e UBT; vizita në institucion](#)]

**Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mjediset mësimore në të dy godinat A & B të FEA, janë të pajisura me pajisje të teknologjisë së informacionit që garantojnë lidhjen me internet sipas nevojave të përdoruesve.

Sallat e leksionit janë të pajisura me videoprojektorë dhe tabela bashkëkohore.

Megjithëse programi i studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar, në dispozicion të studentëve të programit është një nga gjashtë laboratorët e informatikës të FEA, laborator i statistikës.

**Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.

Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ky laborator përdorej nga studentët kryesisht për realizimin e temave të kursit, të diplomës apo për aftësimin e pavaruar në programe të analizës së informacionit si Gretl, E-views dhe SPSS.

**Kriteri 4.** Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së

informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	<p>Në dispozicion të studentëve ishte edhe laboratorit i kontabilitetit ku ata mund të aftësoheshin lidhur me përdorimin e programeve për kontabilitetin si Financa 5.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 53-Kapacitetet e UBT; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB si dhe informacionit të marrë takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se institucioni garanton zhvillimin e praktikave profesionale në përputhje me kërkesat e parashikuara në programin e studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”.</p> <p>Aktualisht, për të mundësuar kryerjen e praktikës profesionale për studentët, Qendra e Karrierës dhe Alumni e UBT, ka ndërmjetësuar rreth 43 marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje private, institucione publike, organizata jo-fitimprurëse.</p> <p>Gjithashtu në nivel universiteti pritet që të rriten kapacitetet për praktika profesionale me zhvillimin e mëtejshëm të Fermës Didaktike Eksperimentale të UBT, pas investimit publik në kuadër të “Paktit për Universitetin”.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 7. Rregullore e Studimeve për Programin EA, 2017.pdf; 37. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UBT vë në dispozicion të gjithë studentëve dhe stafit të tij, bibliotekën e universitetit “Mentor Përmeti” dhe bibliotekën e FEA. Bibliotekat janë të organizuara me disa ambiente dhe funksionojnë kundrejt anëtarësimit me kartelë regjistrimi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët e këtij programi studimi frekuentojnë kryesisht bibliotekën pranë FEA me një kapacitet prej 100 vende.</p> <p>Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të FEA si: tekste mësimore bazë dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë dhe botime të institucioneve të tjera.</p>



	Biblioteka mund të shfrytëzohet njëloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit. <i>[Referenca: 53. Kapacitetet e UBT; 54. Plani Strategjik i Bibliotekes.pdf; 55. Biblioteka- Informacion.pdf; 56. Lista e hyrjeve të reja bibliografike Mars 2019.pdf; vizita në institucion]</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Në takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UBT, falë projekteve të ndryshme të bashkëpunimit, u mundëson akses të barabartë dhe të lirë në disa biblioteka online si COBISS+ dhe LNSS. Gjithashtu UBT është pjesë e projektit të MASR për ofrimin e shërbimeve të bibliotekës on-line për universitetet publike “ULIBRARY”.			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Përmes adresave elektronike përkatëse, studentët mund të kërkojnë për artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së tyre të interesit. Sallat e studimit të bibliotekave janë të pajisura me teknologjinë e nevojshme (kompjuteri, videoprojektorë, fotokopje etj) të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët dhe pedagogët në aktivitetet mësimore dhe kërkimore. <i>[Referenca: 55. Biblioteka- Informacion.pdf; https://ubt.edu.al/sq/biblioteka-e-universitetit-bujqesor-te-tiranes/; vizita në institucion]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se institucioni është i angazhuar në shtimin dhe përditësimin e fondit të bibliotekës dhe i ka përfshirë këto objektiva në prioritetet e zhvillimit strategjik afatgjatë.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstaton se oraret e shërbimit të bibliotekës (nga e hëna-të premtë dhe orari 8.30-16.00) janë në përputhje me nevojat e studentëve të këtij program studimi por edhe të studentëve të tjerë të UBT. <i>[Referenca: 54. Plani Strategjik i Bibliotekes.pdf; 56. Lista e hyrjeve të reja bibliografike Mars 2019.pdf; vizita në institucion]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional (SZHKVI) është struktura që administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe



<p>deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi.</p> <p>Gjatë takimit me sekretarinë GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen fizike të dy studentëve të programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” dhe konstatoi plotësinë e tyre si dhe përdorimin e regjistrave përkatës (themeltar &amp; të arritjeve akademike) sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Përveç dokumentacionit dhe arkivës letër, GVJ konstatoi se në faqen web të UBT është integruar Sistemi ESSE3, një shërbim software për menaxhimin e proceseve akademike dhe administrative të universiteteve i ofruar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH). UBT në marrëveshje me RASH, e përdor këtë sistem të informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme e FEAs, 2017.pdf; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe të marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” realizohet nga disa struktura në varësi të natyrës së informacionit.</p> <p>Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural menaxhon dokumentacionin lidhur me aktivitetin mësimor dhe kërkimor të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore &amp; Pagave administron dosjet e plota personale të të gjithë personelit të UBT, ndërsa Drejtoria e Financës &amp; e Buxhetit administron informacionin lidhur me kategoritë, nivelet e ngarkesës, pagesat etj. Informacioni në dosjet përkatëse përditësohet rregullisht për të reflektuar ndryshimet e ndodhura në kualifikime, pozicione etj.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT 2017.pdf; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 11. Rregullore e Burimeve Njerëzore, 2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se sistemi i integruar ESSE3, i ofruar nga RASH, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit. Gjithashtu sistemi ESSE3 ofron funksionalitetet e nevojshme të komunikimit si për aspektet administrative të universitetit si: regjistrimet, tarifatat etj; ashtu dhe për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve universitare: si programet mësimore sipas cikleve të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përveç sistemit ESSE3, GVJ konstatoi se në faqen web të UBT nëpërmjet aplikacionit Google Sites janë integruar faqet individuale web të pedagogëve të UBT. Në këto faqe web, lehtësisht të përdorshme nga të gjithë të interesuarit, jepen informacione të detajuara lidhur me lëndët që mbulon secili pedagog në programe të ndryshme të studimit</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të</p>	

<p>aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>në UBT (syllabuese, prezantime të leksioneve në powerpoint, materiale ndihmëse, informacione mbi detyrat e kursit, detyrimet e tjera lidhur me programin mësimor etj).</p> <p>GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UBT garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 58. Manual i regjistrimit të studentëve ne vitin e pare.pdf; 59. Manual per perdorimin e "GOOGLE APPS".pdf; 60. Struktura e faqes zyrtare UBT.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të UBT publikohet në gjuhën shqipe informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>[Referenca: 60. Struktura e faqes zyrtare UBT.pdf; https://ubt.edu.al/sq/]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare të kostove sipas programeve të studimit por vetëm në nivel universiteti dhe për periudha vjetore që përkrijnë me vitin buxhetor, i cili fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Raportet financiare përbëhen nga pasqyrat financiare vjetore të UBT, një relacion përmbledhës mbi pasqyrat, akti i rakordimit i të ardhurave dhe shpenzimeve, një kopje e inventarëve gjendje në fund të vitit financiar dhe kopje e certifikatave të pronësisë për aktivet që zotëron UBT. Në këto raporte treguesi kosto për një student llogaritet si një mesatare e thjeshtë në nivel universiteti e raportit të shpenzimeve faktike (ose të parashikuara) kundrejt numrit total të studentëve të regjistruar (ose të parashkuar për t'u regjistruar). Për vitin 2018 kosto mesatare rezultonte 118'900 lekë për student dhe për vitin 2019 parashikohej 136'300 lekë për student.</p> <p>Sipas Statutit të UBT, projektbuxheti i vitit pasardhës hartohet nga Rektorati në përputhje me propozimet e bëra në nivel fakulteti dhe në nivel departamenti. Pas vlerësimit nga Senati Akademik projektbuxheti miratohet nga Bordi i Administrimit i UBT. Në takimet me drejtuesit e FEA dhe me stafin akademik të programit, GVJ konfirmoi se</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe</p>	

<p>zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>departamenti dhe fakulteti si pjesë të analizës vjetore përfshijnë edhe propozimet për parashikime financiare në funksion të programeve të studimit lidhur me investime në pajisje, infrastrukturë, pasurim literature etj. Megjithatë, ndihet i nevojshëm decentralizimi financiar më konkret në nivel fakulteti dhe departamenti.</p> <p>Në projektbuxhet shpenzimet janë të klasifikuara kryesisht sipas natyrës së tyre (pagat dhe sigurimet; shpenzime operative; shpenzime për transfertat me jashtë; bursa për studentët; ndihmë ekonomike; investime etj), ndërsa të ardhurat janë të klasifikuara sipas dy burimeve kryesore të parashikuara të financimit (fonde të grantit qendror dhe fonde nga të ardhurat e kushtëzuara).</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 63. Raporti financiar 2018.PDF; 64. Detajimi i Buxhetit UBT_2016-2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas Statutit, kontrolli dhe auditimi i brendshëm në institucion realizohet nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit të UBT. Kjo strukturë zhvillon aktivitetin në përputhje me Ligjin nr 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM 83/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njëjësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Raportet e auditimit të brendshëm kryesisht fokusohen në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucionit dhe njëjësive përbërëse me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Gjithashtu UBT si institucion buxhetor është objekt i auditimit të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH).</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare në mbyllje të një cikli të plotë studimi tre vjeçar, por në raportet e analizës vjetore në nivel institucioni analizohen të ardhurat dhe shpenzimet mbi bazë viti buxhetor dhe bëhet edhe një analizë krahasuese e realizimit të tyre kundrejt shumave të buxhetuara më parë.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT, 2017.pdf; <a href="http://www.klsh.org.al/?search=universiteti+bujqesor">http://www.klsh.org.al/?search=universiteti+bujqesor</a>; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>UBT është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë të RSH. Sipas statutit, burimet e financimit të UBT janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore.</p> <p>Fondet e buxhetit të shtetit në përputhje me udhëzimet e MFE shpërndahen në formë granti për politikën e zhvillimit të UBT, për mësimdhënien dhe për punën kërkimore-shkencore e veprimtaritë</p>

	<p>krijuese. Përdorimi i fondeve publike nga UBT bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.</p> <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se për periudhën 2016-2018 ecuria e të ardhurave të realizuara paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Viti 2016 rreth 70% fonde të grantit qendror dhe 30% fonde nga të ardhurat e kushtëzuara;</li> <li>▪ Viti 2017 rreth 76% fonde të grantit qendror dhe 24% fonde nga të ardhurat e kushtëzuara;</li> <li>▪ Viti 2018 rreth 74% fonde të grantit qendror dhe 26% fonde nga të ardhurat e kushtëzuara.</li> </ul> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 63. Raporti financiar 2018.PDF; 64. Detajimi i Buxhetit UBT_2016-2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UBT, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantojnë edhe nga kërkesat (nenet) specifike të statutit dhe rregullores së UBT, si dhe të rregullores respektive të FEA dhe të Departamentit të Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural. Kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi propozohen nga departamenti dhe miratohen nga fakulteti përkatës në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Pas miratimit
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve,	

<p>përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>të kriterëve të pranimit në nivel universiteti nga Senati Akademik i UBT, Rektorati vijon me publikimin e tyre.</p> <p>Sipas rregullores përkatëse, Zyra e Studimeve &amp; Studentëve (ZSS) në varësi të Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave &amp; Vlerësimit Institucional, monitoron zbatimin e politikave dhe procedurave që nga hyrja deri në diplomim të studentëve në secilin program studimi pranë UBT.</p> <p>Në takimin me studentët e këtij programi studimi dhe nga faqja web e UBT, GVJ konstatoi se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 4. Rregullore e Studimeve_UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; <a href="https://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/">https://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/</a>; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion lidhur me pranimin e studentëve të rinj, GVJ konstatoi se UBT harton dhe publikon kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për përzgjedhjen e kandidatëve për pranim sipas secilit program dhe cikël studimesh, çdo vit dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Rregullorja e FEA parashikon edhe regjistrimin e studentëve me shtetësi të huaj që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga MASR për ndjekjen e studimeve në ciklin bachelor. Ndjekja e zbatimit të kriterëve të përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve realizohet nga zyra e zv/Rektorit për mësimin të UBT, Zyra e Studimeve &amp; Studentëve (ZSS) dhe Qendra e Karrierës &amp; Alumni (QKA).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se DEPZHR luan një rol mjaft aktiv në informimin e të gjithë të interesuarve në lidhje me UBT, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to. Në fillim të vitit akademik përditësohet faqja web e FEA me informacion mbi programet e studimit, strukturën e tyre, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimeve, modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Gjithashtu, gjatë periudhës që paraprin procesin e plotësimit të formularit për pranimin në institucione të arsimit të lartë, stafi akademik dhe ndihmës akademik i UBT organizon, sipas planit të aktiviteteve të QKA, vizita informuese mbi programet e veta të studimit bachelor, në shkollat e mesme të përgjithshme e profesionale në të gjithë vendin.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e</i></p>



	<i>brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 61. Raporti i Performancës e QKA, 2018.pdf; 86. Vendim rektorati Nr 8 Datë 30.01.2019.jpg; https://ubt.edu.al/wp-content/uploads /2019/04 /Kriteret-2018-2019.pdf; vizita në institucion]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UBT, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Konkretisht GVJ konstatoi që kriteret lidhur me pranimin e studentëve në programet e studimit, regjistrimin e studentëve, kushtet e kalimit në vitet pasuese deri në diplomim, transferimi i krediteve dhe ekuivalentimi i moduleve etj janë pjesë e rregullores së FEA të publikuar në faqen web zyrtare të UBT.  Gjithashtu studentët e programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës që në momentin e regjistrimit pranë UBT, si dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme nga stafi akademik i DEPZHR, nga sekretaria mësimore e departamentit, nga specialistët e shërbimit të ZSS, si dhe nëpërmjet platformës ESSE3. Sipas Statutit të UBT, vendimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve, me qëllim vazhdimin e studimeve e merr Komisioni i Ekuivalentimit të departamentit që pranon studentin. i njëjti departament në rregulloren e tij të brendshme përcakton edhe kriteret e procedurat e transferimit të studimeve.  <i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 4. Rregullore e Studimeve UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; vizita në institucion]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara në faqet web të pedagogëve (në platformën google site të integruar në faqen web zyrtare të UBT) dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimit, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	



<p>procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët e programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”, GVJ konstatoi se studentët ishin të informuar edhe lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi.</p> <p>Në përputhje me rregulloren e UBT, rregulloren e programit të studimit dhe brenda muajit të parë të vitit të akademik, DEPZHR nëpërmjet Sekretarisë Mësimore njofton të gjithë studentët e interesuar rreth procedurës së diplomimit, me provim apo mbrojtje të një punimi në varësi të rezultateve të dy viteve të para të studimit. Në rastin e diplomimit me provim, Grupet Mësimore Kërkimore të departamentit përgatisin një listë pyetjesh dhe përcaktojnë procedurën e përzgjedhjes me short. Në rastin e një punimi diplome, fusha e punimit përcaktohet në përputhje me fushat e studimit që mbulon departamenti dhe miratohet nga drejtuesi i DEPZHR që kujdeset për të respektuar edhe kërkesat e studentëve lidhur me zgjedhjen e temës dhe udhëheqësit. Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrimi financiar ndaj UBT, është kusht i domosdoshëm për të vijuar me procesin e diplomimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 7. Rregullore e Studimeve për Programin EA, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UBT, GVJ konstatoi se gjatë periudhës që paraprin procesin e plotësimit të formularit për pranimin në institucione të arsimit të lartë, stafi akademik dhe ndihmës akademik i UBT organizon, sipas planit të aktiviteteve të QKA, vizita informuese mbi programet e veta të studimit bachelor, në shkollat e mesme të përgjithshme e profesionale në të gjithë vendin.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstatoi se në fillim të vitit akademik QKA në bashkëpunim me departamentet përkatëse, përgatit dhe përditëson fletëpalosje, udhëzues dhe materiale të tjera informuese si dhe promovon programet e studimit në faqen web të UBT, rrjetet sociale dhe takime me grupe të ndryshme interesi.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 61. Raporti i Performancës e QKA, 2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.3</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën,</p>	

<p>organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe nga faqja web zyrtare e UBT, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” informohen nga pedagogët përkatës dhe sekretaria mësimore e DEPZHR për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi.</p> <p>GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese si fletëpalosje dhe broshura të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit të vendosura në ambientet e UBT dhe në faqen zyrtare web të institucionit. Përmes hapësirës së dedikuar në platformën ESSE3, në faqen web të UBT mund të konsultohet udhëzuesi online për studentët me informacione të përditësuara mbi programet, veprimtaritë mësimore, grafikun dhe rezultatet e provimeve etj.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 7. Rregullore e Studimeve për Programin EA, 2017.PDF; <a href="https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/ListaAppelliOfferta.do?jsessionid=F98F">https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/ListaAppelliOfferta.do?jsessionid=F98F</a>; 61. Raporti i Performancës e QKA, 2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) ishte struktura që kujdesej kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit në fund të ciklit të studimeve.</p> <p>Nga takimi me Kordinatorin e saj rezultoi se QKA në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të UBT, informon, orienton dhe mbështet studentët e UBT, duke krijuar mundësi për realizimin e praktikave dhe trajnimeve të ndryshme, duke lehtësuar komunikimin me tregun e punës si edhe duke ndjekur ecurinë e tyre pas diplomimit. Panairi i Karrierës është një nga aktivitetet kryesore që realizon QKA në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve me Biznesin, me Zyrën e Studimeve &amp; Studentëve dhe me stafin pedagogjik për t’u dhënë mundësi studentëve të UBT të familjarizohen me tregun e punës dhe kërkesat e tij.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 61. Raporti i Performancës e QKA, 2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se sekretaria mësimore dhe pedagogët e DEPZHR luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Nëpërmjet faqes web zyrtare të UBT dhe hapësirës së dedikuar në platformën ESSE3, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet dhe aktivitete të tjera të UBT. Gjithashtu studentët mund të regjistrohen në leksione dhe seminare sipas programit të studimit, mund të</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet</p>	

të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	konsultojnë orarin mësimor, grafikun dhe rezultatet e provimeve si edhe materialet e postuara nga pedagogët në faqet tyre individuale të integruara në faqen zyrtare të UBT.			
	<i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 4. Rregullore e Studimeve_UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 7. Rregullore e Studimeve për Programin EA, 2017.PDF; 58. Manual i rregjistrimit të studentëve ne vitin e pare.pdf; vizita në institucion]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>									
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>									
<b>Kriteret</b>		<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>							
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.		Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UBT mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit.							
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.		Konkretisht, Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional (SZHKVI) me Zyrën e Studimeve & Studentëve (ZSS) dhe sektori i Informacionit & Transferimit të Njohurive me tri zyra në varësi (Informacioni & Statistika, Marrëdhëniet me Biznesin dhe Qendra e Karrierës & Alumnit) janë strukturat, në varësi të zv/Rektorit për mësimin, që administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për çdo program studimi.							
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.		Gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Nga statistikat e sekretarisë mësimore për këtë program studimi (2014-2019) rezulton se ka pasur 3 studentëve të ardhur me transferim studimesh nga IAL të tjera dhe 17 studentëve të çregjistruar nga programi.  Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” dhe konstatoi plotësinë e tyre. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 4 vitet e fundit paraqiten si vijon:							
		<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Të diplomuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2016-2017</td> <td>63 studentë</td> <td>41 studentë</td> </tr> </tbody> </table>		Viti akademik	Të regjistruar	Të diplomuar	2016-2017	63 studentë	41 studentë
Viti akademik	Të regjistruar	Të diplomuar							
2016-2017	63 studentë	41 studentë							

	<table border="1"> <tr> <td>2017-2018</td> <td>91 studentë</td> <td>50 studentë</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>90 studentë</td> <td>51 studentë</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>91 studentë</td> <td>Info në proces</td> </tr> </table>			2017-2018	91 studentë	50 studentë	2018-2019	90 studentë	51 studentë	2019-2020	91 studentë	Info në proces
2017-2018	91 studentë	50 studentë										
2018-2019	90 studentë	51 studentë										
2019-2020	91 studentë	Info në proces										
	<p>Shifrat e regjistrimeve në këtë program studimi gjatë harkut kohor 2016-2019 flasin për një qëndrueshmëri të numrit të regjistrimeve, në përputhje me kuotat e miratuara nga MASR. Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi.</p> <p><i>[Referenca: 4. Rregullore e Studimeve_UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 33. Evidenca sekretaria mësimore 2019.pdf; vizita në institucion]</i></p>											
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UBT.</p> <p>Zyra e Studimeve &amp; Studentëve dhe Zyra e Informacionit &amp; Statistikave kujdesen drejtpërdrejt për ruajtjen e informacionit në formatin letër (në arkivë fizike) dhe në versionin elektronik (në sistemin e brendshëm informatik ESSE3). Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin dhe përdorimin e të dhënave nga personat e autorizuar, si edhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>[Referenca: 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 4. Rregullore e Studimeve_UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; vizita në institucion]</i></p>											
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se njësi bazë DEPZHR analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (statistika bazuar në notën mesatare), si dhe kalueshmërinë sipas lëndëve dhe programeve të studimit. Ky informacion është pjesë e analizës vjetore të punës së njësisë bazë dhe shoqërohet me rekomandime dhe masa për përmirësime. Që prej Tetorit 2017, UBT është kordinator i projektit GRADUA i cili ka për qëllim të krijojë sinergji konkrete mes Universitetit dhe tregut të punës përmes ofrimit të një instrumenti unifikues për vlerësimin e të diplomuarve dhe performancës së sistemit universitar, si dhe lehtësimin të procesit të rekrutimit nga punëdhënësit.</p> <p><i>[Referenca: 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 46. Analiza mesimore-shkencore DEPZHR, 2017-2018.PDF; 75. Raportim Projekti GRADUA Erasmus+.pdf; 76. Broshura_GRADUA.pdf; vizita në institucion]</i></p>											
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>								
				<b>X</b>								

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezultoi se UBT në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundur ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti e në nivel Universiteti, si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të UBT, në Komisionet e për Sigurimin e Cilësisë (Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Cilësisë dhe Kurrikulave) dhe në Bordin e Administrimit të UBT.</p> <p>GVJ konstatoi se në statutin e UBT dhe rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur me mandat 2-vjeçar në një proces transparent.</p> <p><i>[Referenca: 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 34. Vendim KIZ për njësitë dhe individët e përfshirë SSBC.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë gjatë takimit me stafin akademik të DEPZHR, rezultoi se në hartimin dhe ndryshimet e bëra në vite në programin e studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” është mbajtur parasysh ngarkesa akademike e studentëve. Gjithashtu shpërndarja e krediteve dhe syllabuset e lëndëve (moduleve) janë të strukturuar në mënyrë të tillë që lehtësojnë procesin e transferimit të studentëve si nga jashtë UBT ashtu dhe ndërmjet programeve brenda FEA të UBT.</p> <p>Përveç përfshirjes së studentëve në vendimmarrje, përmes strukturave të garantuara nga statuti dhe rregulloret e UBT, GVJ konstatoi se aktualisht institucioni përdor në fund të çdo semestri pyetësin për studentët për të vlerësuar procesin mësimor, stafin akademik sipas lëndëve (moduleve), programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin si dhe një pyetësor online për vlerësimin e aktivitetit mësimor e kërkimor ku vlerësohet puna e strukturave ndihmëse. Rezultatet e pyetësorëve janë objekt diskutimi në të gjitha strukturat e UBT dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmer departmenti.</p> <p><i>[Referenca: 27. Elementët e Programit të Studimit.pdf; 46. Analiza mesimore-shkencore DEPZHR, 2017-2018.PDF; 49. Pyetësori i studentit 2017-2018.pdf; 50. Pyetësori Online i Studentit, 2019.pdf; 51. Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se Rregullorja e UBT, Rregullorja e FEA dhe Rregullorja e Programit të Studimit, parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, deri në 48 orë nga marrja e rezultatit të provimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve,</p>	



<p>përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Ankesa i paraqitet me shkrim fillimisht përgjegjëses së DEPZHR, që ndjek procedurën e parashikuar në rregullore për verifikimin e pretendimeve të studentit dhe marrjen e masave (në rast nevojë) për një datë të re provimi brenda ditës ose të nesërmen, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve.</p> <p>Gjithashtu studentët në fund të çdo semestri, mund të përdorin edhe pyetësorët përkatës për të shprehur mendimin e tyre lidhur me cilësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.</p> <p><i>[Referenca: 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 7. Rregullore e Studimeve për Programin EA, 2017.PDF; 49. Pyetësori i studentit 2017-2018.pdf; 50. Pyetësori Online i Studentit, 2019.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstatoi se në statutin dhe rregulloret e UBT parashikohen qartë procedurat dhe strukturat/zyrat e dedikuara në shërbim të studentëve si Zyra e Studimeve &amp; Studentëve dhe Zyra e Mësimit &amp; Kurrikulave në varësi të Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave &amp; Vlerësimit Institucional, si dhe Qendra e Karrierës &amp; Alumni në varësi të Sektorit të Informacionit &amp; Transferimit të Njohurive. Këto zyra janë pjesë përbërëse e strukturës organizative të institucionit, funksionojnë si njësi ndihmëse të rektoratit me lidhje të drejtpërdrejtë me zëvendësrektorin për problemet mësimore dhe dekanët e fakulteteve të UBT.</p> <p>Konkretisht, këto zyra ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor si dhe garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti, si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problemet dhe problematikat e lidhura me studentët.</p> <p><i>[Referenca: 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 61. Raporti i Performancës e QKA, 2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, organigramës dhe rregulloreve të UBT, rezultoi se shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Qendra e Karrierës &amp; Alumnit (QKA). Kjo zyrë ka në përbërje të saj koordinatoren, drejtues i emëruar nga Rektori i UBT, Bordin Ekzekutiv Alumni si dhe studentë të angazhuar vullnetarisht pranë saj. Gjatë takimit me koordinatoren e QKA, GVJ</p>



<p>mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>konstatoi se veprimtaria e kësaj zyre në bashkëpunim me strukturat e tjera të UBT si ZSS, përfshinte sigurimin e informacioneve orientuese dhe ofrimin e zgjidhjeve për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës së studentëve potencialë, të studentëve aktualë të UBT si dhe gjurmimin e të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjithashtu në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve me Biznesin (ZMB), zyra e QKA synon të shërbejë si një nyje ndërlidhëse midis studentëve të UBT dhe tregut të punës, duke lehtësuar kryerjen e praktikave profesionale të studentëve, duke mundësuar oferta për punësimin e studentëve, si dhe identifikimin e nevojave të bizneseve për konsulencë, trajnime, kërkime etj.</p> <p>Aktualisht zyra e QKA mban statistika të thjeshta mbi studentët e diplomuar pranë UBT, por së shpejti falë projektit GRADUA, në cilin UBT është koordinator që prej tetorit 2017, do të vihet në përdorim një platformë e integruar informacioni në shërbim të studentëve dhe të tregut të punës që synon lehtësimin e procesit të rekrutimit nga punëdhënësit përmes ofrimit të një instrumenti unifikues për vlerësimin e të diplomuarve dhe të performancës së sistemit universitar. Në hapësirën e dedikuar të faqes zyrtare web të UBT, gjenden të publikuara aktivitetet e realizuara nga QKA si Panairi i Karrierës, Ditët e informimit të maturanëve dhe dokumenta si udhëzuesi i aplikimit për vende pune.</p> <p><i>[Referenca: 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 61. Raporti i Performancës e QKA, 2018.pdf; 62. Punësimi real i studentëve 2016-2018.xls; 75. Raportim Projekti GRADUA Erasmus+.pdf; 76. Broshura_GRADUA.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p><b>Standardi VI.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, statutit dhe rregulloreve të UBT, GVJ konstatoi se procedurat dhe politikat për</p>

<p>me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Përgjegjësia institucionale e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë i takon Zyrës së Sigurimit të Cilësisë &amp; Vlerësimit Institucional (ZSCVI), në varësi të Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Insitucionale të UBT. Në nivel fakulteti dhe universiteti organizohen dhe funksionojnë Komisionet e Përhershme të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit &amp; Kërkimit Shkencor me anëtarë të përzgjedhur nga asambleja e personelit akademik si dhe me përfaqësues nga asambleja e studentëve.</p> <p>Në planin strategjik të UBT, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, bazuar në analizën SWOT të realizuar në ndihmë të planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë si një kërkesë themelore për rritjen e reputacionit të UBT brenda dhe jashtë vendit. Në këtë dokument identifikohen qartë synimet dhe objektivat, rezultatet e pritshme, si dhe hapat e veprimet e nevojshme për t’u ndërmarrë për të garantuar një zhvillim të qendrueshëm të strukturave dhe gjithë sistemit të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Një tjetër dokument i rëndësishëm, në shërbim të mirëfunksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë është dhe Manuali i Sigurimit të Cilësisë, që paraqet: parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë; proceset dhe mekanizmat e monitorimit, vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies &amp; mësimnxënies; vlerësimin e kërkimit shkencor, vlerësimin e shërbimeve për studentët, infrastrukturën dhe menaxhimin në UBT. Ky manual është hartuar nga ZSCVI dhe përditësohet rregullisht prej saj, pasi marrjes së miratimit për ndryshimet nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit &amp; Kërkimit Shkencor dhe Senati Akademik.</p> <p><i>[Referenca: 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 3. Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 9. Manuali i Cilësisë, 2018.pdf; 34. Vendim KIZ për njësitë dhe individët e përfshirë SSBC.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Gjatë vitit 2017 UBT i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional dhe në përfundim ka marrë vlerësim pozitiv, të shoqëruar me disa rekomandime, nga Bordi i Akreditimit.</p> <p>Konkretisht me vendimin Nr.11 të Bordit të Akreditimit të ASCAL, datë 07.04.2017 UBT ka marrë akreditimin institucional me kohëzgjatje 4 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 06.04.2021. GVJ konstatoi se në përgjigje të rekomandimeve, UBT ka përfshirë në programin e masave për mirëadministrimin e vitit akademik dhe masat për plotësimin e këtyre rekomandimeve.</p>

	[Referenca: 66. Vendim Akreditimi UBT.pdf; 67. Program Masash_2018-2019.pdf; vizita në institucion]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<p>GVJ konkludon se në rregulloret dhe manualët e UBT paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. Gjithashtu realizohen studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga UBT. Rezultatet e pyetësorëve dhe studimeve gjurmuese bëhen pjesë e analizave vjetore në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti.</p> <p>GVJ vlerëson se informacioni në lidhje me politikat dhe praktikat që lidhen me sigurimin e cilësisë në UBT janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit (personel akademik, administrativ, si dhe studentë) të cilët bashkëpunojnë dhe janë të angazhuar për zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë dhe nxitjen e rritjes së cilësisë në të gjitha nivelet.</p> <p>[Referenca: 4. Rregullore e Studimeve_UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 6. Rregullore e brendshme DEPZHR, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 9. Manuali i Cilësisë, 2018.pdf; vizita në institucion]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, statutin dhe rregulloret e UBT, GVJ konstatoi se monitorimi, shqyrtimi, mbikëqyrja dhe rishikimi i programeve të studimit të ciklit të parë të realizohet nga disa struktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave &amp; Vlerësimit Institucional me: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Zyrën e Mësimit &amp; Kurrikulave;</li> <li>○ Zyrën e Sigurimit të Cilësisë &amp; Vlerësimit Institucional;</li> </ul> </li> <li>▪ Komisionet e Përhershme të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor;</li> <li>▪ Zëvendës Rektori për Mësimin;</li> </ul> <p>në bashkëpunim me strukturat dhe personelin akademik të fakultetit dhe departamentit përgjegjës për programin e studimit.</p>

	<i>[Referenca: 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Në takimin me drejtuesen e DEPZHR dhe personelin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se në UBT përdoren procedura formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	<p>Çdo fillim viti akademik në departament miratohen syllabuset e lëndëve/moduleve dhe reflektohen propozimet e pedagogëve për ndryshime në to bazuar në studime periodike të tregut, në propozimet e bashkëpunëtorëve dhe në komentet e të studentëve, si dhe në përputhje të plotë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësi studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. Gjithashtu rregullorja e këtij program studimi parashikon vlerësimin e punës së pedagogëve përgjatë semestrit nga komisioni për kryerjen e kontrolleve në leksione si dhe anketimin e pedagogëve dhe stafit ndihmës bazuar në indikatorët e performancës të përcaktuar në nivel fakulteti dhe universiteti.</p> <p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstatoi se në nivel universiteti, Zyra e Sigurimit të Cilësisë &amp; Vlerësimit Institucional harton kalendarin e procesit të vetëvlerësimit dhe monitoron realizimin e tij ndërsa Zyra e Mësimit &amp; Kurrikulave ndjek problemet lidhur me mësimin, përgatitjen e programeve të rinj të studimit për të gjithë ciklet e studimit, si dhe realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese që ofrohen në UBT.</p> <p><i>[Referenca: 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; 7. Rregullore e Studimeve për Programin EA, 2017.PDF; 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 9. Manuali i Cilësisë, 2018.pdf; 65. Relacion mbi përmirësimin e kurikulës 16.10.2017.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues, rezultoi se në mbledhjet e departamentit DEPZHR në fund të çdo semestri mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, çështjet e evidentuara nga pyetësorët e studentëve dhe rezultatet e anketave dhe vizitave vlerësuese për pedagogët. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të përgatitur nga përgjegjësja e departamentit dhe që komunikohet në strukturave të UBT sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Raporti i analizës përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, studentët, stafin akademik dhe grupet mësimore-kërkimore, si dhe problematikave të evidentuara nga pyetësorët dhe vlerësimet e tjera të realizuara. Raporti mbyllet me konkluzionet dhe rekomandimet për përmirësimin e problematikave të evidentuara.
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Në nivel universiteti Struktura e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës & Vlerësimit Institucional (SZHKKVI) dhe Struktura e Informacionit

	<p>&amp; Transferimit të Njohurive (SITNJ) në bashkëpunim me Zv/Rektorin për mësimin përgatisin analizën vjetore të veprimtarisë mësimore të Universitetit dhe ia referojnë atë Senatit Akademik. Në këtë raport evidentohen qartë objektivat dhe metodologjia e përgatitjes së tij dhe analizohen në nivel universiteti zhvillimet vjetore lidhur me procesin mësimor, studentët, pedagogët dhe infrastrukturën e UBT. Problematikat e evidentuara për secilin prej këtyre aspekteve shoqërohen me rekomandime dhe plan masash për trajtimin e mangësive dhe përmirësim të mëtejshëm.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017.pdf; 44. Analiza Mësimore e FEAs 2017-2018.pdf; 46. Analiza mesimore-shkencore DEPZHR, 2017-2018.PDF; vizita në institucion]</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqëruar, GVJ konstatoi se DEPZHR gjatë periudhës 2017-2018 ka realizuar edhe dy studime tregu për programin e studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar” në vijim të studimit të tregut të bërë para hapjes së programit. Ky informacion është përfshirë në dosjen e vetëvlerësimit dhe përfundimet përkatëse janë mbajtur parasysh edhe në analizat periodike të departamentit me qëllim përmirësimin e programit dhe reflektimin në kurrikula të kërkesave të tregut të punës dhe prioritetëve të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 25. Studim Tregu për programin Ekonomiks i Aplikuar, 2017.PDF; 26. Studim Tregu për programin Ekonomiks i Aplikuar, 2018.PDF; 44. Analiza Mësimore e FEAs 2017-2018.pdf; 46. Analiza mesimore-shkencore DEPZHR, 2017-2018.PDF; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në Manualin e Cilësisë të UBT përshkruhen parimet, procedurat dhe metodat për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë si dhe përcaktohen modelet e pyetësorëve dhe deklarimeve të tjera që përdoren në këtë proces.</p> <p>Në takimin me drejtuesen e DEPZHR dhe personelin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi se në UBT përdoren metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit si: analiza bazuar në tregues të matshëm cilësisë si nota mesatare në hyrje, kalueshmëria sipas lëndëve/moduleve, vlerësime të punës së</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i</p>	



<p>cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>pedagogëve përgjatë semestrit nga komisioni për kryerjen e kontrolleve në leksione, rishikime vjetre të syllabuseve, analiza e infrastrukturës në dispozicion të procesit mësimor si dhe përfshirja e eksperiencave më të mira ndërkombëtare, rezultat i angazhimit të stafit akademik në projektet “exchange mobility”.</p> <p><i>[Referenca: 9. Manuali i Cilësisë, 2018.pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017.pdf; 44. Analiza Mësimore e FEAs 2017-2018.pdf; 46. Analiza mesimore-shkencore DEPZHR, 2017-2018.PDF; 52. Formular vlerësimi i stafit.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstatoi se në UBT përdoren rregullisht edhe teknikat e tërthorta të vlerësimit si pyetësorët e studentëve për vlerësimin e procesit mësimor në fund çdo semestri. QKA e UBT në bashkëpunim me strukturat e tjera të UBT organizon Panairin e Karrierës, që shërben edhe për përfshirjen e bashkëpunëtorëve jashtë UBT në procesin e vlerësimit. Gjithashtu, pranë QKA funksionon dhe Bordi i ALUMNI, si një organ konsullativ që synon përfshirjen e ish-studentëve në aktivitetet dhe shkëmbimin e eksperiencës në UBT. Aktualisht, po punohej edhe për zbatimin në fund të semestrit të dytë të pyetësorit të pedagogëve dhe stafit ndihmës bazuar në indikatorët e performancës të përcaktuar në nivel fakulteti dhe universiteti.</p> <p><i>[Referenca: 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017.pdf; 44. Analiza Mësimore e FEAs 2017-2018.pdf; 46. Analiza mesimore-shkencore DEPZHR, 2017-2018.PDF; 49. Pyetësori i studentit 2017-2018.pdf; 50. Pyetësori Online i Studentit, 2019.pdf; 51. Pyetësori i stafit akademik dhe ndihmës akademik.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të</p>	<p>Në rregulloren e Strukturës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës &amp; Vlerësimit Institucional (SZHKKVI) përcaktohet qartë organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e zyrave përbërëse si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Gjithashtu në Manualin e Cilësisë paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në UBT, roli i strukturave akademike dhe administrative në</p>

studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të UBT.</p> <p><i>[Referenca: 8. Rregullore e DZHKKVI &amp; DITNJ, 2017.pdf; 9. Manuali i Cilësisë, 2018.pdf; 34. Vendim KIZ për njësitë dhe individët e përfshirë SSBC.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, statutin dhe rregulloret e UBT, GVJ vlerëson se UBT garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p> <p>Në takimin me drejtuesen dhe stafin akademik të këtij programi studimi, GVJ konstatoi se DEPZHR përditësohet dhe kontribuon në mënyrë të rregullt në procesin e vlerësimit të brendshëm me analiza, raporte dhe sugjerime mbi vlerësimet e bëra nga strukturat e SZHKKVI. Në Kodin e Etikës së UBT jepen parimet e etikës akademike dhe publike të detyrueshme për të gjithë, në përputhje me misionin dhe vizionin e institucionit, si edhe shprehet qartë angazhimi i UBT për respektimin e integritetit dhe shmangien e diskriminimit duke adresuar në mënyrë të kujdesshme të gjitha problemet etike të studentëve dhe personelit gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; https://ubt.edu.al/sq/kodi-i-etikes/; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstaton në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit synohet edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë kthyer në një traditë në jetën universitare të UBT dhe strukturat përkatëse i shfrytëzojnë edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 61. Raporti i Performancës e QKA, 2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstaton në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit synohet edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë kthyer në një traditë në jetën universitare të UBT dhe strukturat përkatëse i shfrytëzojnë edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 61. Raporti i Performancës e QKA, 2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

**Standardi VI.5**  
**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen zyrtare web të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ vlerëson se publikimet në faqen zyrtare web të UBT respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes komunikimeve në platformën ESSE3.</p> <p><i>[Referenca: 2. Statuti UBT, 2017.pdf; 5. Rregullore e brendshme FEAs, 2017.PDF; <a href="https://ubt.edu.al/sq/">https://ubt.edu.al/sq/</a>; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se raportet e vlerësimit (analizat vjetore) shoqërohen me rekomandime dhe plane masash për përmirësimin e cilësisë duke filluar që nga njësia bazë.</p> <p>Në mbledhjet e departamentit, stafi akademik analizon në mënyrë aktive ecurinë dhe problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe sugjeron masa në përputhje me gjetjet. Në përfundim të diskutimeve në nivel njësie bazë dhe kryesore, si dhe bazuar në propozimet e bëra prej tyre, hartohet në nivel universiteti plani i masave që miratohet nga Senati Akademik.</p> <p><i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017.pdf; 44. Analiza Mësimore e FEAs 2017-2018.pdf; vizita në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Megjithëse nuk konstatoi ndonjë sistem vlerësimi të posaçëm për matjen e efektivitetit dhe ndikimit të këtyre veprimtarive për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, GVJ vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e stafit akademik për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në UBT, GVJ konstatoi se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri lidhen me mbledhjet e asamblesë, publikime në faqen zyrtare web të UBT dhe platformën ESSE3, si dhe publikime në rrjetet sociale, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>

	<i>[Referenca: RVB_Bachelor_Ekonomiks_i_Aplikuar.pdf; 40. Analiza mësimore UBT, 2016-2017.pdf; 44. Analiza Mësimore e FEAs 2017-2018.pdf; vizita në institucion]</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Ekonomiks i Aplikuar” të “Universitetit Bujqësor të Tiranës.”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Niveli i lartë i kualifikimit të stafit të programit të studimit i demonstruar jo vetëm në numrin e pedagogëve me gradë Profesor dhe Profesor i Asociuar, por edhe në numrin e lartë të botimeve në vit për çdo pedagog dhe në cilësinë e revistave në të cilat janë bërë publikimet.
2. Diploma unike për sektorin e bujqësisë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe barasvlefshmëria e saj në rajon, Europë dhe botë.
3. Eksperiencia shumë dimensionale dhe përkushtimi i stafit akademik dhe ndihmës të angazhuar në programin e studimit Bsc në “Ekonomiks i Aplikuar”.
4. Tradita e UBT dhe zhvillimi historik i tij, veçanërisht metodika e punës e mbështetur në akte rregullatore e udhëzime, të cilat udhëheqin dhe koordinojnë aktivitetin e çdo njësie (fakultet/ departament).
5. Liria akademike dhe fleksibiliteti, që nxisin stafin akademik drejt kërkimit shkencor.
6. Mbështetja, këshillimi, bashkëpunimi dhe udhëheqja e studentëve përgjatë aktivitetit akademik në UBT.
7. Përshtatshmëria dhe lehtësia e procedurave të transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, rrjedhojë e vëmëndjes së institucionit ndaj përmirësimit cilësor të programit dhe harmonizimit të tij me kërkesat e tregut.
8. Imazhi ndërkombëtar i UBT dhe marrëdhëniet e mira me operatorët e tregut të punës dhe institucionet e tjera publike dhe jo publike.

**Pika të dobëta:**

1. Shkalla e lartë e centralizimit, sidomos financiar dhe mundësitë financiare të kufizuara të njësisë përgjegjëse, veçanërisht për mbështetjen e pjesëmarrjes në konferenca apo aktivitete të tjera shkencore.

2. Kapacitete të kufizuara administrative për të përballuar ngarkesën e punës në njësinë përgjegjëse për programin.
3. Infrastrukturë mbështetëse e kufizuar për jetën studentore: si ngrohja e disa ambienteve, mungesa e mensës për studentët, si dhe transporti publik i papërshtatshëm.
4. Mungesa e analizave vlerësuese të efektivitetit të bashkëpunimeve ndërinstitucionale dhe ndikimit të këtyre veprimtarive për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.
5. Mungesa e raporteve financiare të dedikuara sipas programeve dhe cikleve të studimit, si dhe përcaktim i kostos për student në total, në nivel institucioni.

### **Rekomandime:**

1. Më shumë transparencë në lidhje me punësimin e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi si dhe në krijimin e mundësive të punësimit për studentët aktualë përmes bashkëpunimeve me tregun e punës.
2. Më shumë decentralizim financiar dhe operativ në nivel fakulteti dhe departamenti, në funksion të autonomisë financiare të parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi dhe një rishpërndarja e përgjegjësive akademike dhe administrative në funksion të këtij decentralizimi.
3. Të përmirësohen kapacitetet administrative dhe infrastruktura ndihmëse në shërbim të studentëve dhe të sigurimit të kushteve sa më bashkëkohore të zhvillimit të procesit mësimor.
4. Të hartohen raporte financiare të dedikuara sipas programeve të studimit, në mbyllje të një cikli të plotë studimi tre vjeçar dhe me evidencë të qartë të kostos për student.
5. Të bëhen analiza të posaçme të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe të ngrihet një sistem vlerësimi i dedikuar për matjen e efektivitetit dhe ndikimit të veprimtarive bashkëpunuese për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.
6. Të ndryshohet emërtimi i diplomës së këtij programi studimi (duke hequr përcaktimin 'profil'), në përputhje me urdhërin nr.586 datë 18.12.2019 të MASR.





**Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle, Bachelor in “Applied Economics” at the HEI “Universiteti Bujqësor i Tiranës” (UBT).**

**Strengths and affirmations:**

1. The high level of qualification of the academic staff of this study program demonstrated not only by the number of lecturers with tenured position, but also by the numbers of publications per year and the quality of journals in which publications have been made.
2. Uniqueness of this study program for the agricultural sector in the Albanian higher education market and its equivalence in the region, Europe and the worldwide.
3. The multidimensional expertise and the commitment of the academic and support staff engaged at the study program Bsc in “Applied Economics”.
4. UBT long tradition and its historical development, especially the working methodology based on regulatory frameworks and acts, which guide and coordinate the activity of each unit (faculty/ department).
5. Academic freedom and flexibility, which motivate academic staff towards scientific research.
6. Continuous support, counseling, and guidance of students during the academic life at UBT.
7. The adequacy and ease of the procedures of transfer, and the study program equivalence, as a result of the attention of the UBT to the qualitative improvement of the program and its harmonization with the market demands.
8. UBT international image and the good relations with labor market operators and other public and non-public institutions.

**Weak points:**

1. High degree of centralization, especially financial and limited financial possibilities of the responsible unit for the study program, especially to support participation in conferences or other scientific activities.
2. Limited administrative capacity to cope with the workload of the unit responsible for the study program.
3. Limited capacity of infrastructure in support of the student life: such as central heating of buildings, lack of canteen for students, as well as inadequate public transport.
4. There is a lack of use of evaluative analysis about the effectiveness of inter-institutional cooperations and their impact on quality improvement of the study program.
5. Lack of financial reports dedicated to study programs and level, and very broad definition of cost per student at the institutional level.

**Recommendations:**

1. More transparency regarding the employment tracking of former students of this study program and the creation of employment opportunities for actual students through cooperation with labor market.

2. More financial and operational decentralization at the faculty and department level, in function of the financial autonomy provided by the legal framework in force and a redistribution of academic and administrative responsibilities in function of this decentralization.
3. To improve the administrative capacities and the infrastructure in support of students' lives and to ensure contemporary conditions for the development of the teaching process
4. To conduct a more complete financial analysis according to the study programs, at the end of a three-year study level, and with clear evidence of the cost per student.
5. To conduct special analyzes of the benefits of cooperation agreements and set up an evaluation system dedicated to measure the effectiveness and impact of cooperations in quality improvement of the study program.
6. To change the name of the diploma of this study program (removing the definition 'profile'), in accordance with the order no.586 dated 18.12.2019 of Ministry of Education, Sport and Yourth (MASR).

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X